



Raporti Vjetor 2010

Përmbajtja e Lëndës

- 2 BKT Nëpërmjet Shifrave
- 4 Momente të Rëndësishme
- 5 Grupi Çalik
- 6 Bordi Drejtues
- 8 Menaxhimi i Lartë
- 10 Mesazhi i Kryetarit të Bordit Drejtues
- 12 Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm
- 14 Çmimet dhe Vlerësimet në vitin 2010
- 16 Dega e Kosovës
- 18 Vlerësim i Aktiviteteve të 2010-ës
- 19 Bankingu Individual
- 23 Bankingu i Korporatave
- 25 Bankingu Tregtar
- 27 Thesari dhe Institucionet Financiare
- 27 Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- 29 Burimet Njerëzore
- 31 Perspektiva për Vitin 2011
- 32 Raporti i Auditorëve të Pavarur
Pasqyrat Financiare të Konsoliduara



OMBETARE TREGTAR



Banka Kombëtare Tregtare (BKT) është regjistruar në janar të vitit 1993, pas bashkimit të Bankës Tregtare Shqiptare (BTSH) me Bankën Kombëtare të Shqipërisë (BKSH) dhe u regjistrua si kompani aksionere në vitin 1997. Gjithsesi, historia e saj i ka fillimet më 30 nëntor 1925, me hapjen e degës së Durrësit, e cila konsiderohet si data zyrtare e krijimit të Bankës, përvjetori i 85 i së cilës u festua në vitin 2010.

BKT Nöpërmjet Shifrave

>>

Treguesit Financiarë

(në mijë dollarë amerikanë (USD))	2008	2009	2010	Ndryshimi % (2009-2010)
Totali i Aktivit	1,161,290	1,340,042	1,509,902	12.7
Hua dhe Paradhënie për Klientët	385,774	494,271	551,046	11.5
Depozitat e Klientëve	1,047,955	1,167,147	1,309,652	12.2
Kapitali Aksioner	63,400	78,299	84,622	8.1
Totali i Kapitalit Aksioner	83,855	94,671	118,670	25.4
Fitimi neto	19,544	13,044	25,003	91.7

Raportet Kyçe

Treguesit e Performancës (%)	2008	2009	2010
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	17.78	13.24	13.06
Kthimi nga aktivet mesatare ROAA	1.58	1.10	1.83
Kthimi nga kapitali ROE	29.87	12.90	25.35
Kreditë me probleme / portofoli bruto i kredive (PAR 90)	3.96	5.05	8.47

Struktura Aksionere

Çalik Finansal Hizmetler, degë e Çalik Holding e Turqisë u bë pronari i vetëm dhe i plotë i BKT-së në vitin 2009.


Struktura aksionere deri më 31 dhjetor 2010	Numri i aksioneve	Totali në USD	%
Çalik Finansal Hizmetler A.Ş.	6,852,000	84,622,200	100

Strategjitë e suksesshme të BKT-së janë reflektuar në rezultatet e mira financiare dhe operacionale në vitin 2010.



Totali i Aktivit (në milionë USD)


\$ 1,510 milionë



Në vitin 2010, aktivet gjithsej të BKT-së u rritën me 12.7% dhe arritën shifrën prej 1,510 milionë dollarë.

Fitimi Neto (në milionë USD)


\$ 25 milionë



Thujse dyfishoi shifrën e 2009-ës. BKT siguroi një fitim neto prej 25 milionë dollarësh.

Numri i Degëve (duke përfshirë Kosovën)


72



Me shtimin e 4 degëve të reja, rrjeti i BKT-së u zgjerua në 72 degë në fund të vitit 2010.

Huatë (në milionë USD)


\$ 551 milionë



Duke dëshmuar një rritje prej 11.5% në vitin 2010, totali i huave të dhëna nga BKT arriti në 551 milionë USD.

Përqindja e Depozitave në Treg (%)


16.7%



Si rezultat i strategjive të saj të suksesshme, pjesa e tregut e BKT-së në depozita u rrit në 16.7%.

Numri i Personelit (duke përfshirë Kosovën)

922



Në vitin 2010, numri i përgjithshëm i personelit të BKT-së arriti në shifrën 922, 68 më shumë se në vitin 2009.

Momente të rëndësishme

>>



Në vitin 2010, BKT festoi 85 vjetorin e hapjes së Degës së Durrësit.

Megjithëse e krijuar në vitin 1925, Banka Kombëtare Tregtare (BKT) ka filluar të punojë me këtë emër në vitin 1993.

1993

Banka Kombëtare Tregtare (BKT) u krijua në janar të vitit 1993, pas bashkimit të Bankës Tregtare Shqiptare (BTSH) dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë (BKSH).

1997

Banka Kombëtare Tregtare (BKT) u krijua si shoqëri aksionere në korrik 1997, me aktive që arrinin vlerën e 2.7 miliardë lekësh.

2000

Banka Kombëtare Tregtare (BKT) përfundoi procesin e saj të privatizimit. Aksionerët e rinj investuan 10 milionë dollarë amerikanë, gjë e cila çoi në një kapitalizim më të fortë të Bankës.

2001

Struktura e aksionerëve të rinj i solli transformime të mëdha BKT-së, duke përfshirë zhvillimin e një infrastrukture të re dhe ristrukturimin e aspekteve të funksioneve të Bankës.

2003

- Kapitali i paguar arriti shifrën e 14.64 milionë dollarësh, duke e transformuar BKT-në në bankën më të kapitalizuar në të gjithë sistemin bankar në Shqipëri.
- BKT mori çmimin "Banka më e Mirë e Vitit në Shqipëri" nga revista "The Banker".

2006

- 60% e aksioneve të BKT-së iu transferuan Çalik-Şeker Konsorsiyum Yatırım A.Ş.
- BKT mori çmimin "Banka më e Mirë e Vitit" nga revista "The Banker".

2007

BKT hap një degë të re në Prishtinë, Kosovë, në nëntor të vitit 2007, duke realizuar kështu investimin e parë të huaj.

2009

- BKT u bë 100% degë e Çalik Group pas blerjes së pjesës së mbetur të aksioneve nga Çalik Finansal Hizmetler.
- BKT u vlerësua si "Banka më e Mirë në Europën Juglindore për vitin 2009".

2010

- BKT festoi 10 vjetorin e privatizimit të saj .
- BKT festoi 85 vjetorin e hapjes së Degës së Durrësit.
- BKT mori çmimin "Banka më e Mirë e Vitit në Shqipëri" nga revista "The Banker".

Grupi Çalık

>>



Ahmet Çalık - Kryetar i Çalık Holding dhe Sali Berisha - Kryeministri i Shqipërisë, në ceremoninë e organizuar për prezantimin e produkteve elektronike bankare.



Ahmet Çalık - Kryetar i Çalık Holding duke folur në ceremoninë e organizuar për prezantimin e produkteve elektronike bankare.



Shoqëritë Tregtare të Grupit Çalık janë konkurrese të forta në arenën ndërkombëtare, pasi ato janë të përfshira në sektorë dhe shtete të ndryshme, duke respektuar e duke qenë të ndjeshme ndaj vlerave njerëzore, sociale dhe mjedisore.

Grupi Çalık është një ndër grupet më të mëdha të Turqisë, aktiv në fushat e financës, energjitikës, ndërtimit, telekomunikacioneve, medias dhe minierave, me më shumë se 20.000 të punësuar në 14 shtete.

Përveç të qenit një punëdhënës i rëndësishëm në Turqi, Grupi Çalık ka qenë një ndër investitorët kryesorë turk në Azinë Qëndrore dhe kohët e fundit është angazhuar më shumë në fushën e telekomunikimit dhe bankave në Ballkan. Grupi Çalık është i përqendruar në krijimin e vlerave të shtuara për të gjithë aktorët e tij nëpërmjet një modeli të shpejtë dhe efektiv rritje, bazuar në parimin e zgjerimit të fushave të tij të veprimit në gjeografi dhe sektorë të ndryshëm.

Krijimi i partneriteteve të forta dhe afatgjata është komponent i rëndësishëm i strategjisë së Grupit, qasje e cila hapi rrugën për bashkëpunim me ENI-n nga Italia, EWE-në nga Gjermania, Autoritetin e Investimeve në

Katar, Mitsubishi-n, BERZH-in dhe IFC-në në shumë fusha zhvillimi.

Grupi është i vendosur të forcojë më tej identitetin e tij si një shoqëri që është e ndjeshme ndaj qytetarëve, aktorëve, shoqërisë në përgjithësi dhe mjedisit, dhe është e angazhuar fort për respektimin e rregullave të etikës.



Bordi Drejtues

>>



Mehmet Usta
Kryetar i Bordit Drejtues



Mehmet Ertuğrul Gürler
Zëvendës Kryetar i Bordit Drejtues

Bordi Drejtues i BKT-së vijon të ushtrojë kompetencat e tij për identifikimin e objektivave dhe projektimin e strategjive të sakta që nevojiten për t'i arritur këto objektiva.



Seyhan Pencaplıgil
Drejtor i Përgjithshëm dhe
Anëtar i Bordit Drejtues



İzzet Serhat Demir
Anëtar i Bordit Drejtues



İsmail Hakkı Ergener
Anëtar i Bordit Drejtues

Menaxhimi i Lartë

>>



Seyhan Pencaplıgil
Drejtori i Përgjithshëm dhe
Anëtar i Bordit Drejtues



Suat Albayrak
BKT Kosovë
Drejtor



Abdurrahman Balkız
Grupi i Operacioneve
Drejtor Grupi



Kaan Pekin
Grupi i Thesarit dhe i Institucioneve Financiare
Drejtor Grupi



Ercüment Korkut
Komiteti Ekzekutiv i Auditimit
Anëtar

Përprojekjet e dedikuara të skuadrës drejtuese profesionale të BKT-së kanë ndikuar shumë në arritjen e rezultateve të shkëlqyera financiare dhe operative në aktivitetin e këtij viti.



Cüneyt Erigüç
Grupi i Bankingut Individual
Drejtor Grupi



Pekhan İşipek
Grupi i Bankingut Tregtar
Drejtor Grupi



Aydın Argın
Grupi i Bankingut të Korporatave
Drejtor Grupi



Skënder Emiri
Divizioni i Kontrollit, Planifikimit dhe
Raportimit Financiar
Drejtor Divizioni




Natasha Ahmetaj
Divizioni i Rrjetit
Drejtoreshë Divizioni



Ndue Maluta
Grupi i Menaxhimit të Riskut
Zëvendës Drejtor Grupi

Mesazhi i Kryetarit

>>



Mehmet Usta
Kryetar

Në vitin 2010 ne vijuar të përmirësonim efikasitetin në biznesin tonë kryesor, duke zgjeruar jo vetëm përpjekjet për marketim dhe shitje, por edhe shtrirjen gjeografike nga njëra anë, ndërsa kemi qenë të përqendruar në zhvillimin e një portofoli huaje edhe më cilësor nga ana tjetër.

Mehmet Usta, Kryetar i Bordit Drejtues të BKT-së, me të ftuar shumë të rëndësishëm, përfshirë Kryeministrin, në ceremoninë e prezantimit të produkteve elektronike bankare.



Të shtyrë nga një strategji e njohur dhe e provuar që jep rezultate mbresëlënëse, BKT ka pasur pozicione kryesuese në treg, ka ofruar nivele të larta kënaqshmërie dhe besimi për klientët e saj dhe ka vijuar të ndjekë objektivin e saj për t'u bërë shoqëria tregtare me rezultatet më të larta financiare në tregun shqiptar gjatë vitit 2010.

BKT është një ndër bankat më shumë të kapitalizuara në sistemin bankar shqiptar, me kapital aksioner që deri në fund të vitit 2010 shkon deri më 118.7 milionë dollarë amerikanë. Në fund të po këtij viti, Banka u rendit si banka e dytë më e madhe në vend për sa i përket aktiveve, të cilat kapin vlerën e 1,510 milionë dollarëve.

Në vitin 2010 ne vijum të përmirësojmë efikasitetin e aktivitetit kryesor, duke zgjeruar jo vetëm përpjekjet për marketim dhe shitje, por edhe shtrirjen gjeografike nga njëra anë, ndërsa kemi vazhduar të përqendrohemi në zhvillimin e portofolit më cilësor të huave në anën tjetër.

Ne kemi dëshmuar një performancë të qëndrueshme dhe të lartë duke arritur një kthim mbi kapitalin neto prej 25.3%, i cili është shoqëruar me një rritje të pjesës së tregut të depozitave në nivelin e 16.7%, niveli më i lartë historik për BKT, në një treg që thuhet se i përket tërësisht grupeve të huaja bankare.

BKT ka kohë që ka njohur rëndësinë e një drejtimi të mirë të brendshëm të shoqërisë, diversitetit, etikës, privacisë dhe sigurisë. Ne i kryejmë aktivitetet tona duke i marrë parasysh të gjitha këto aspekte. Nëpërmjet organizimit tonë, drejtimi i brendshëm i shoqërisë shkon përtej përputhshmërisë me ligjet dhe rregullat individuale. Drejtimi i brendshëm i shoqërisë është ai që udhëheq iniciativat aktive në BKT. Të gjithë punonjësit e njohin dhe pranojnë faktin që integriteti i organizatës tonë dhe besimi i aksionerëve përbëjnë bazën e suksesit të vazhdueshëm të BKT-së.

Nëpërmjet një kombinimi të dhurimeve dhe ndihmës me synime të qarta dhe përfshirjes së punonjësve të saj, BKT vazhdon të investojë në komunitetin ku jetojmë dhe punojmë. Nëpërmjet ofritit të mbështetjes financiare për aktivitete social-kulturore paralelisht me performancën e saj ekonomike për krijimin e vlerave, BKT përmirëson cilësinë e jetës së njerëzve si dhe mirëqenien e tyre materiale.

Ne i japim rëndësi të veçantë çështjes së arsimit. Gjatë të gjithë vitit 2010 ne vijum me programet tona të bursave me Fakultetin e Ekonomisë së Universitetit të Tiranës dhe Universitetin e Durrësit. Në kuadrin e këtyre programeve ne kemi sponsorizuar studentë të rinj e të talentuar, si dhe iu kemi ofruar atyre punë pas diplomimit. Numri i studentëve që kanë përfituar nga bursat e dhëna nga BKT arriti në 69 në vitin 2010.

Më tej, projekti FASTIP, i drejtuar bashkërisht me Universitetin e Durrësit dhe me GTZ-në gjermane vazhdon të realizohet me sukses. Ne presim që ky program, i cili i edukon bankierët e ardhshëm, të japë të diplomuarit e parë në vitin 2011 dhe shpresojmë të shohim të rinj të suksesshëm në radhët tona.

Rezultatet mbresëlënëse të vitit 2010 erdhën si rezultat i përkushtimit, dedikimit, punës së madhe dhe zgjuarsisë së strukturave drejtuese dhe të stafit tonë. Unë jam i bindur për aftësinë e tyre për të shkëlqyer në krijimtarinë e tyre, në përgjigjen ndaj nevojave të klientëve, kolegëve dhe të komunitetit. Është pikërisht optimizmi dhe vizioni i kësaj skuadre që na shtyn ne përpara drejt një 2011-e edhe më të madhe, edhe më shpërblyese.

Në vitin 2010, BKT ka shënuar fitime dhe rritje rekord të aktiveve në historinë e saj. Dëshiroj të falënderoj të gjithë stafin, duke përfshirë punonjësit, klientët, bankat korrespondente dhe institucionet financiare për kontributet e tyre të vyera për arritjen e rezultateve të Bankës.

Mehmet Usta
Kryetar

Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm

>>



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Seyhan Pencapligil'.

Seyhan Pencapligil
Drejtore i Përgjithshëm dhe
Anëtar i Bordit Drejtues

2010 shënjojti një rikthim në përfitueshmërinë e lartë, krahasuar me vitin 2009, kohë gjatë së cilës ne ishim përqëndruar në të qenit të kujdesshëm dhe në likuiditet. Fitimi ynë neto u dyfishua krahasuar me vitin 2009 dhe arriti në 25 milionë dollarë, duke përkuar me një kthim mbi kapitalin prej 25.3%.

Seyhan Pencaplıgil – Drejtor i Përgjithshëm i BKT-së, duke dhënë informacion për hapat e rëndësishme të BKT-së në fushën e produkteve elektronike bankare.



BKT përjetoi një tjetër vit rritje të qëndrueshme në vitin 2010. Ne ia arritëm t'u jepnim formë aktiviteteve tona të biznesit për të stimuluar rritje të qëndrueshme, përfitueshmëri dhe kthim të lartë në kuadrin më afatgjatë.

2010 shënjoi një rikthim në përfitueshmërinë e lartë, krahasuar me vitin 2009, kohë gjatë së cilës ne ishim përqëndruar në të qenit të kujdesshëm dhe në likuiditet. Fitimi ynë neto u dyfishua krahasuar me vitin 2009 dhe arriti në 25 milionë dollarë, duke përkuar me një kthim mbi kapitalin prej 25.3%.

Fitimi dhe rritja e lartë që shënuam rritën pjesën tonë të tregut në të gjitha linjat e aktivitetit. Në vitin 2010 aktivet gjithsej arritën në 1.5 miliardë dollarë, depozitat gjithsej u rritën në 1.3 miliardë dollarë, ndërsa ne ruajtëm pozicionin tonë si banka e dytë më e madhe në Shqipëri.

Në përputhje me vizionin tonë strategjik ne morëm masa për të zgjeruar shtrirjen tonë gjeografike dhe hapëm shtatë agjenci të reja në vitin 2010, nga të cilat katër në Shqipëri dhe tre në Kosovë. Ndërsa kemi shkriër katër degë/agjenci në dy dhe kemi mbyllur një agjenci kufitare, numri i njësisve të rrjetit tonë arriti në 72 (duke përfshirë dhe Kosovën) deri në fund të vitit 2010.

Në vitin 2010 organizuam një aktivitet shumë të rëndësishëm për ne për prezantimin e produkteve bankare elektronike, të cilin e kishim provuar një vit më parë nën "zgjidhjet elektronike bankare". Të ftuar VIP, si Kryeministri, Ministrat dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, si dhe 500 të ftuar të tjerë ishin pjesë e ceremonisë së prezantimit të produkteve elektronike bankare. Besoj se prezantimi, i cili krijoi një përshtypje shumë të mirë në median shqiptare, do të rrisë nivelin e përdorimit të produkteve tona.

Në vitin 2010 ne festuam dhe 85-vjetorin e hapjes të degës sonë në Durrës, datë (30 nëntor 1925) që është tani dhe data zyrtare e themelimit të BKT-së.

BKT iu nënshtrua një riorganizimi radikal në vitin 2010 në përpjekje për të rritur efikasitetin e saj. Ne ndamë Grupin e Bankingut Tregtar dhe të Korporatave në dy grupe: Grupin e Bankingut Tregtar dhe Grupin e Bankingut të Korporatave. Në këtë mënyrë, ndërsa jemi në gjendje t'u shërbejmë me më shumë efikasitet klientëve tanë, ne kemi si synim të zëmë një pjesë më të madhe të tregut. Në të njëjtën kohë, ne presim që struktura e re të sigurojë huadhënie më të shpejtë, më të sigurt dhe më fitimprurëse.

Mjaft projekte domethënëse të ndërmarra një vit më parë janë zbatuar me sukses dhe kanë filluar të jenë operative këtë vit.

Në vitin 2010, siç ishin planifikuar, kemi riprezantuar Super Kreditë, të cilat kanë pasur progres të mirë. Kreditë hipotekore u dyfishuan përsa i përket numrit të dosjeve dhe u rritën me 30% gjatë vitit 2010.

Fondi European për Europën Juglindore (EFSE), i cili është fondi më prestigjioz për huadhënien për ndërmarrjet mikro dhe të vogla (MSE), i dha BKT-së një hua prej 20 milionë eurosh. Marrëveshja e huasë e nënshkruar në nëntor 2010 do të kontribuojë për zgjerimin e veprimeve të Bankës për operacionet huadhënëse dhe do të jetë tregues i angazhimit të BKT-së për ta bërë BKT-në Bankën më aktive tregtare për huadhënien për bizneset e vogla. Kjo është marrëveshja e parë për hua ndërmjet EFSE-së dhe BKT-së dhe trajton mungesën e kredisë afatgjatë për MSE-të shqiptare, të cilat konsiderohen si shtylla kurrizore e zhvillimit ekonomik të vendit.

Ne fituam të drejta shtesë në licencën tonë bankare në vitin 2010, të cilat na lejojnë të kryejmë transaksione të ndryshme ndërmjetësimi financiar, si dhe faktoringun dhe transaksionet me arin.

Ne rritëm kapitalin e paguar nëpërmjet kapitalizimit të fitimeve në 84.6 milionë dollarë amerikanë.

Ashtu siç ka bërë dhe në të shkuarën, BKT do të vazhdojë në ditët në vijim t'i drejtojë fuqitë nga e ardhmja dhe të ofrojë më të mirën e mundshme në shërbime për klientët e saj bazuar në parimet e përfitimit dhe të produktivitetit.

Ne jemi të bindur se rritja jonë financiare do të vazhdojë dhe në vitin 2011, vit në të cilin ne presim të arrijmë një rritje të bilancit prej 27%, në mënyrë që aktivet gjithsej të kalojnë shifrën e 1.9 miliardë dollarëve dhe fitimi neto të arrijë në 36 milionë dollarë. Kjo do ta çojë kapitalin aksioner në 155 milionë dollarë që përkon me një RoE prej 30% për vitin në fjalë.

Me mbështetjen e klientëve tanë, me punën e afërt e të ngushtë të Bordit dhe me përpjekjet e dedikuara të punonjësve tanë, unë jam i sigurt se dhe këto objektiva do të realizohen.

Seyhan Pencaplıgil

Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar i Bordit Drejtues

Çmimet dhe Vlerësimet në vitin 2010

>>



Mehmet Usta, Kryetar Bordi i BKT-së, në Ceremoninë e Çmimit nga "The Bankers"

The Banker zgjodhi BKT-në si “Banka më e Mirë në Shqipëri – 2010”.



Çmimet

Si një ndër institucionet financiare më të njohura dhe më të besuara në Shqipëri, BKT ka marrë vazhdimisht çmime nga organizata ndërkombëtare si banka më e mirë në vend.

Në vitin 2010, The Banker, revista e industrisë bankare e Financial Times, përzgjedhi BKT-në si “Banka më e Mirë e Vitit në Shqipëri – 2010”, bazuar në performancën e bankës gjatë vitit të fundit.

Po ashtu, në vitin 2010, BKT mori ISO 9001:2008, që është certifikatë e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, e lëshuar nga instituti italian Certiquality, që përdoret për shërbimet bankare.



Vlerësimet

Agjencitë e njohura botërore afirmojnë dhe një herë se BKT është një ndër bankat më të besueshme dhe financiarisht më të forta në Shqipëri.

BKT është e vetmja bankë në Shqipëri që është vlerësuar me AAA (Alb) nga institucioni prestigjioz Japan Credit Rating Agency – Eurasia Rating. Në vitin 2010 JCR – ER ka konfirmuar vlerësimin e saj AAA me një situatë të qëndrueshme, ndërsa Moody’s e ka vlerësuar Bankën me B1, i cili është vlerësimi më i lartë që mund të marrë një subjekt shqiptar sipas metodologjisë së tij.

Dega Kosovë

>>

E licencuar në vitin 2007, dega e BKT-së në Kosovë ka përfunduar me sukses vitin e saj të tretë të punës dhe ka arritur shifra shumë të kënaqshme në vitin 2010.

E licencuar në vitin 2007, dega e BKT-së në Kosovë ka përfunduar me sukses vitin e saj të tretë të punës dhe ka arritur shifra shumë të kënaqshme në vitin 2010. Aktivitetet dhe depozitat kanë shënuar një rritje domethënëse: totali i aktiveve dhe depozitave arritën përkatësisht shifrën prej 60% dhe 14%, të cilat të përkthyer në euro kanë përkatësisht vlerën e 34.1 milionë eurove dhe 5.4 milionë eurove. Totali i aktiveve arriti vlerën 91 milionë euro, ndërsa totali i depozitave arritën shifrën prej 43.3 milionë euro në fund të vitit 2010. Huatë gjithsej u rritën gjithashtu me 78%, duke arritur vlerën 67.9 milionë euro, duke zënë 5% të tregut. Fitimi neto u rrit me rreth 1 milionë euro, duke shënuar një kthim mbi kapitalin prej 15.4%.

Në përputhje me strategjinë e saj të rritjes, BKT e Kosovës ka hapur tre degë të reja në vitin 2010, duke e zgjeruar rrjetin e saj në 15 njësi. Duke iu shërbyer klientëve me stafin e saj të dedikuar prej 117 punonjësve, BKT vijoi të jetë në pozicion drejtues në Kosovë. Falë produkteve financiare të përdorura për herë të parë, të tillë si Prima Këste, numri i klientëve u rrit në 30 mijë nga 12 mijë një vit më parë.

BKT Kosovë u rizgjodh në vitin 2010, ashtu si në vitin 2009, si shoqëruësja e parë e "Kompanisë më të Mirë në Sektorin e Shërbimeve në Kosovë", një vlerësim i bërë nga qeveria e

Kosovës nëpërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë. Me një ekonomi që ka një tendencë rritjeje, sektori bankar në Kosovë, i cili është një ndër forcat shtytëse të rritjes ekonomike të vendit, po rritet po ashtu fuqishëm. Sektori bankar në Kosovë ka aktive totale prej rreth 2.5 miliardë euro. BKT synon të rritet fuqishëm duke u përqendruar tek përfitueshmëria në të gjitha kohërat.

BKT parashikon që tregtia të rritet vitin që vjen; bazuar në këtë parashikim, ajo ka si synim të rrisë pjesën e saj të tregut dhe të dyfishojë shifrat.



Në përputhje me strategjinë e saj të rritjes, BKT hapi tre degë të reja në vitin 2010.




Numri i klientëve u rrit në 30 mijë në vitin 2010, nga 12 mijë që ishte në vitin 2009.

BKT e Kosovës u rizgjodh në vitin 2010, ashtu si në vitin 2009, si shoqëruesja e parë e “Kompanisë më të Mirë në Sektorin e Shërbimeve në Kosovë”, një vlerësim i bërë nga qeveria e Kosovës nëpërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë.



Totali i Aktivit (në milionë euro)


91.0 milionë euro



Në vitin 2010, totali i aktivitetit të BKT-së në Kosovë u rrit me 59.9% dhe arriti shifrën e 91.0 milionë euro.

Totali i Kredive (në milionë euro)


67.9 milionë euro



Totali i kredive të BKT Kosovës pësoi një rritje të ndjeshme prej 77.7% në vitin 2010.

Numri i Degëve


15



Numri i përgjithshëm i degëve ka shkuar në 15 pas 3 degëve të reja që janë hapur në vitin 2010.

Totali i Depozitave (në milionë euro)

43.3 milionë euro



Me një rritje prej 14.2% në vitin 2010, totali i kredive të BKT Kosovë arriti shifrën e 43.3 milionë euro.

Fitimi Neto (në milionë euro)


1.0 milionë euro



Në vitin 2010, BKT Kosovë regjistroi një fitim neto prej 1.0 milionë euro.

Numri i Personelit

171



Numri i përgjithshëm i punonjësve në BKT Kosovë në fund të vitit 2010 ishte 171 vetë, kundrejt 42 vetëve që punonin në vitin 2009.

Vlerësim i Aktiviteteve të 2010-ës

>>



BKT u shërben klientëve të saj individualë me portofolin e saj të gjerë të produkteve dhe shërbimeve, duke qënë në gjendje t'i përgjigjet nevojave të ndryshme financiare të individëve.



Bankingu Individual

Në këtë kuadër, BKT është përqendruar në marrjen e pjesës më të madhe të tregut brenda potencialit rritës të ofruar nga linja e biznesit të bankingut individual. Superioriteti i saj teknologjik dhe qasja novative mbështesin bashkërisht e në mënyrë të qëndrueshme BKT-në në objektivin e saj për të rritur bankingun individual.

Viti 2010 ishte viti i vijimit të prezantimit të iniciativave të ndërmarra nga BKT në të gjitha fushat e bankingut individual. Zhvillimi më i rëndësishëm ishte prezantimi i zgjidhjeve të shërbimeve elektronike bankare në një aktivitet të posaçëm, ku morën pjesë, ndër të tjerë, dhe Kryeministri, Ministrat dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

Prezantimi i Zgjidhjeve Elektronike Bankare të BKT-së u organizua më 26 tetor, 2010. Ky ishte aktiviteti më i madh i organizuar ndonjëherë në historinë e Shqipërisë. Në të morën pjesë rreth 500 të ftuar dhe u prezantuan pesë produkte të reja.

Karta Prima - I pari program i kartave të kreditit me këste i prezantuar ndonjëherë në Shqipëri. I pajisur me teknologjinë Chip & Pin, Kartat Prima u ofrojnë përdoruesve opsione për blerje me këste nga 2-12 mujore. Në vitin 2010 BKT mori licencën e pranimit të kartave Visa, duke i lejuar pajisjet e saj POS të procesojnë si kartat Visa ashtu edhe ato MasterCard. Në këtë mënyrë, u zgjerua dhe më tej fusha e përdorimit të Kartës Prima.



Karta Prima - I pari program i kartave të kreditit me këste i prezantuar ndonjëherë në Shqipëri.



M-D: Seyhan Pencapligil – Drejtor i Përgjithshëm i BKT-së, Ahmet Çalık – Kryetar i Çalık Holding dhe Sali Berisha – Kryeministër i Shqipërisë në ceremoninë e organizuar për prezantimin e produkteve elektronike bankare.



Me licencën e marrë nga Visa, fusha e veprimit të Kartës Prima u zgjerua edhe më tej.

>>

Dega "Internet" - E konsideruar si banka me shërbimet më funksionale nëpërmjet internetit në Shqipëri, Dega "Internet" e BKT-së u zhvillua më tej në vitin 2010, ndërsa numri i përdoruesve të saj u katërfishua. Aktualisht ajo u shërben vetëm klientëve individualë, por Dega "Internet" e BKT-së do të hapë degën e saj edhe për bizneset vitin që vjen.

Pagesat Top-up - BKT është e para bankë në Shqipëri që ka zbatuar praktikën e pagesave Top-up. Kjo praktikë i dedikohet përdoruesve të telefonave celularë dhe zbatohet sëbashku me Eagle Mobile, e cila është një shoqëri e grupit, e që ka fituar një shtrirje të gjerë në treg.

Mobile Banking- Mënyra më e thjeshtë e realizimit të transaksioneve bankare u prezantua në vitin 2010. Konsumatorët individë të BKT-së tani janë në gjendje të kryejnë transfertat bankare, të kontrollojnë llogaritë e tyre dhe gjendjen e llogarisë së kartës së kreditit nëpërmjet teknologjisë më të fundit të kryerjes së veprimeve bankare nëpërmjet celularit.

ATM-të - ATM-të janë kthyer në zyra këmbimi valutor falë rritjes së funksioneve të tyre. Klientët lejohen të lidhin llogaritë e tyre në monedha të ndryshme me kartën e tyre të debitit dhe të tërheqin të holla në lek ose në euro, sipas nevojave të tyre.

Rritja e pjesës së tregut në bankingun individual

Në vitin 2010 BKT formuloi strategjinë e saj të përgjithshme për kreditë individuale duke i kushtuar vëmendje të veçantë rritjes së kredive hipotekore dhe qëndrueshmërisë së pjesës së saj të tregut në sektor. Si rezultat, portofoli i kredive individuale të bankës ka performuar mbi sektorin.

Bazuar tek të dhënat në fund të vitit, volumi i kredive për individë të dhëna nga BKT për klientët e saj u rrit me 35 milionë dollarë duke arritur në 179 milionë dollarë.



Dega "Internet" e BKT-së - banka më funksionale e shërbimeve nëpërmjet internetit në Shqipëri.



ATM-të e BKT-së tani kryejnë dhe transaksione FX dhe përdoren për të tërhequr lek dhe euro.

Bazuar tek të dhënat në fund të vitit, volumi i kredive për individë të dhëna nga BKT për klientët e saj u rrit me 35 milionë dollarë duke arritur në 179 milionë dollarë.



Në vitin 2010, BKT vijoi të ishte banka e preferuar nga një numër në rritje i klientëve individualë për të depozituar kursimet e tyre dhe rriti shtrirjen e saj në treg për depozitat falë strategjive të shërbimeve të përqendruara tek klientët dhe gamës së gjerë të produkteve.

Përsa i përket depozitave, BKT është banka e dytë më e madhe në Shqipëri dhe zotëron 16.7% të tregut. Në vitin 2010, totali i depozitave u rrit me 12%, duke kapur shifrën prej 1,310 milionë dollarësh.

Produkte dhe aplikime të reja që u ofrojnë shërbim më të mirë klientëve


Në vitin 2010 BKT kreu fushata specifike për të inkurajuar përdorimin e kartave të kreditit. Fushatat për blerje me këste dhe me interes zero, të cilat ofrohen për ditë të veçanta, si për shembull, për Ditën e Nënës, Ditën e Shën Valentinit, Ditën e Vitit të Ri, që janë një tjetër risi në tregun shqiptar, kanë rezultuar shumë të mirëpritura nga klientët.

Për transfertat e parave BKT ka nënshkruar një marrëveshje me MoneyGram, kompani e cila ofron shërbimin e transferimit të parave në të gjithë botën dhe që punon ngushtë me agjentë të zgjedhur posaçërisht në më shumë se 200.000 pika, në më shumë se 190 shtete dhe territore. Kjo marrëveshje i lejon qytetarët shqiptarë që jetojnë jashtë shteti të dërgojnë lehtësisht para në degët e BKT-së nëpërmjet MoneyGram.


BKT përqendron vëmendjen e saj tek praktikat për të rritur kënaqshmërinë e klientëve në fushën e produkteve të depozitës. Në këtë kuadër, për herë të parë në Shqipëri, klientëve u është dhënë mundësia të paguajnë faturat e tyre të telefonit, faturat e energjisë elektrike dhe faturat e ujit nëpërmjet degëve të BKT-së si dhe Degës "Internet". Më tej, pagesat periodike fikse, të tilla si qiratë, tarifat e regjistrimit, etj. paguhen automatikisht nga llogaria rrjedhëse.



BKT është banka e parë në Shqipëri që përdor praktikën e pagesës Top-up.



Klientët individualë të BKT-së tani janë në gjendje të kryejnë transaksione nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së fundit të kryerjes së veprimeve bankare nëpërmjet celularit.



BKT kreu një ndryshim strukturor për ofrimin e produkteve të personalizuar, në përputhje me pritjet dhe nevojat e klientëve, në mënyrë që të rrisë kënaqshmërinë dhe besnikërinë e klientëve.



Bankingu i Korporatave

Një strukturë e re

Si rezultat i një vendimi strategjik, Grupi i Bankingut Tregtar dhe Korporatave, i cili më parë ishte i organizuar si pjesë e një strukture për t'ju shërbyer klientëve të tij, u nda në dy grupe: në Grupin Bankingut Tregtar dhe në Grupin e Bankingut të Korporatave në mënyrë që të ofrojë shërbime më produktive dhe më të mira.

Që prej ndarjes, e cila hyri në fuqi më 1 nëntor 2010, Grupi i Bankingut të Korporatave u organizua në dy departamente, përkatësisht Departamentin e Bankingut të Korporatave dhe Departamentin e Financës së Strukturuar.

Zhvillim i qëndrueshëm në portofolin e kredive

Duke u përqendruar në zhvillimin e marrëdhënieve afatgjata me klientët aktualë dhe potencialë të biznesit, dhe për të ofruar zgjidhje kreative financiare të cilat përkojnë me nevojat e tyre, Grupi i Bankingut të Korporatave ka shënuar rezultate shumë të kënaqshme në vitin 2010.

Deri më 31 dhjetori 2010, portofoli i kredive të BKT-së për korporatat arriti në 203.3 milionë dollarë amerikanë, duke dëshmuar një rritje reale prej 30.1%. Numri i klientëve dhe portofoli i kredive të korporatave nga totali i kredive të BKT-së (kesh dhe jo-kesh) u rrit gjithashtu nga 50.2% në vitin 2009 në 56.2% në vitin 2010.



BKT përqendrohet në zhvillimin e marrëdhënieve afatgjata me klientët ekzistues dhe potencialë të korporatave.

Vit aktiv për aktivitetet e financës së strukturuar

Në vitin 2010 BKT ruajti një rritje të qëndrueshme përsa i përket volumeve të huave dhe të kontratave të instrumenteve të financimit tregtar.

- Vlera e portofolit u rrit me 18%
- Portofoli i volumit të kontratave u rrit me 29%
- Numri i kontratave u rrit me 35%

Një projekt i rëndësishëm i ndërmarrë nga BKT në vitin 2010 ishte përfundimi i marrëveshjes së linjës së kreditimit të financimit tregtar me Korporatën e Financimit të Tregëtisë Islamike për një shumë prej 3.8 milionë euro.

BKT është banka e parë në Shqipëri dhe në rajon që ka nënshkruar një marrëveshje me ITFC-në në lidhje me Financimin Murabaha. Marrëveshja hyri në fuqi në fillim të nëntorit 2010.

Më tej, BKT vijoi negociatat me BERZH-in për të përfunduar një Projekt për Efikasitetin e Energjisë. Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshje është ofrimi i iniciativave dhe ekspertizës në fushën e efikasitetit të energjisë për Bizneset Shqiptare.

Aktivitete të tjera të rëndësishme të kryera gjatë vitit 2010 dhe që kanë vijuar dhe gjatë vitit 2011 janë: KfW Credit Guarantee Facility, USAID Credit Guarantee Facility, Projekti AZHBR dhe Programi i Huamarrjeve për SME-të me METE-n.

BKT është e përqendruar në realizimin e rritjes në segmentin e financës së strukturuar. Si në rastin e vitit 2010, Banka do të vazhdojë të japë më shumë fonde për nevojat në rritje të klientëve të saj dhe në vitet në vijim.



BKT është e përqendruar në rritjen e segmentit të financës së strukturuar.



Bankingu i korporatave dhe ai tregtar u ndanë në dy pjesë në mënyrë që t'i përgjigjen pritshmërive në rritje, të rrisin përqendrimin dhe të ulin ngarkesën e punës.



Bankingu Tregtar

Grupi i Bankingut Tregtar Tregtar eci përpara me operacione në vitin 2010

I angazhuar për të ofruar më shumë shërbime të përqendruara për klientët e tij tregtarë dhe të SME-ve që e shtrijnë aktivitetin e tyre në të gjithë vendin, departamenti i Bankingut Tregtar filloi t'i shërbente ndërmarrjeve tregtare dhe publike në vitin 2010 me organizimin e tij të ri.

Mbështetje e vazhdueshme për SME-të

Në zemër të procesit të zhvillimit ekonomik në Shqipëri, ndërmarrjet e vogla deri në të mesme (SME) vijuan të marrin mbështetje të pandërprerë nga BKT.

BKT ofron produkte dhe shërbime bankare që plotësojnë nevojat e SME-ve nga sektorë të ndryshëm.

Përveç disa përpjekjeve të përgjithshme, janë ofruar dhe disa lehtësi të posaçme nëpërmjet marrëveshjeve të ndryshme të ndërsjella.

Më e rëndësishmja ndër to është huaja prej 20 milionë eurosh e dhënë nga EFSE (Fondi European për Europën Juglindore) për të financuar ndërmarrjet mikro dhe të vogla (MSE). Marrëveshja është nënshkruar në nëntor 2010. Falë niveleve preferenciale të interesit dhe maturimit 7-vjeçar të ripagimit (pa ripagime në dy vitet e para), kjo është huaja e parë e këtij lloji në Shqipëri.

Një tjetër projekt, i njohur si SME italiane, është një strukturë krediti e ofruar nga qeveria italiane për qeverinë e Shqipërisë. E synuar për SME-të, ky projekt është një program afatgjatë, me interes të ulët që ofron kushte shumë të arsyeshme.

BKT është banka më aktive në Shqipëri si përsa i përket numrit edhe përsa i përket shumës totale të huave që ajo jep.



Marrëveshja për huanë 20 milionë euro nga EFSE (Fondi European për Europën Juglindore) për SME-të u nënshkrua në vitin 2010.

>>

Projekte në vazhdim, në bashkëpunim me sektorin publik: huadhënia për agro-biznesin dhe për njësitë e pushtetit vendor

Janë prodhuar shumë oferta konstruktive dhe konkurruese për klientë specifikë në sektorin publik, të tilla si huadhënia për subjektet publike, pagesat e pagave, depozitat publike, etj.

BKT ka kryer dy projekte të rëndësishme në bashkëpunim me sektorin publik që prej vitit 2010. Një ndër këto projekte lidhet me çështjen e huave për sektorin bujqësor, i cili subvencionohet gjerësisht nga Ministria e Bujqësisë. BKT u përzgjodh si një ndër dy bankat në Shqipëri që operon në këtë fushë. Një përqindje domethënëse e huave tregtare të dhëna nga BKT janë hua të lidhura me bujqësinë.

Po ashtu, BKT ka një program të përbashkët me USAID-in që lidhet me financimin e pushtetit vendor. Si pjesë e lehtësimit të garancisë së nënshkruar me USAID-in, administratat lokale financohen nga bankat, nga të cilat BKT është një ndër bankat më aktive në këtë treg.

BKT do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në financimin publik duke zbatuar produktet e reja dhe në bashkëpunimin me organizata të tjera për të rritur efikasitetin në të ardhmen.



Shumë oferta konstruktive dhe konkurruese janë prodhuar për klientë specifikë në sektorin publik.



Në vitet në vijim, BKT do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në financat publike.

Në BKT, procesi i menaxhimit të thesarit dhe institucioneve financiare kryhet mbi bazën e vlerësimit të vazhdueshëm të zhvillimeve në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përdorimit të teknikave efektive për menaxhimin e riskut.



Thesari dhe Institucionet Financiare

Njësia e Thesarit dhe e Institucioneve Financiare të BKT-së vazhdoi të luajë një rol aktiv në tregjet ndërkombëtare për financimin e kërkesave të bankës. Duke kryer transaksione forfeiting që prej fundit të vitit 2009, BKT ka marrë pjesë edhe në kreditë e përbashkëta me banka të mëdha turke. Kredia e parë e përbashkët u realizua në tetor 2009, dhe mori formë të plotë në vitin 2010.

BKT vizitoi 20 banka në Gjermani dhe Austri në vitin 2009. Gjatë këtyre vizitave Banka kërkoi të hynte në bashkëpunim me homologët e saj. Po ashtu, në vitin 2010 u kryen 100 vizita të tjera në nëntë shtete të ndryshme gjatë 7 turneve. BKT organizoi dy vizita në Rajonin e Gjirit Persik, i cili paraqet interes të veçantë për BKT-në. Ky rajon përfaqëson një zonë ku asnjë bankë në Shqipëri nuk ka pasur ndonjëherë marrëdhënie biznesi.

Në vitin 2010 BKT ka marrë pjesë në emetimin e eurobonos si organizuesi kryesor (Lead Arranger) me një shumë prej 15 milionë eurosh. Më tej, gjatë vitit 2010, BKT ka blerë Eurobondin e emetuar nga Mali i Zi nga tregu parësor dhe u bë pjesë e sindikimit të emëruar nga Banka VTB në Austri.

Duke u përpjekur të tërheqë pjesën më të madhe të tregut në transaksionet e tregtisë me jashtë të Shqipërisë gjatë periudhës në vijim, BKT ka kërkuar të shkojë përtej identitetit të saj lokal dhe të ndër marrë hapa të fortë drejt të qenit një bankë ndërkombëtare.



BKT synon të thithë pjesën maksimale të transaksioneve të tregtisë së jashtme të Shqipërisë në periudhën në vijim.

Përgjegjësia Sociale e Korporatës

BKT është një korporatë e dedikuar dhe e përgjegjshme në aspektin social, e cila mbështet aktivitetet me vlerë të komunitetit dhe i inkurajon anëtarët e saj të përfshihen aktivisht në komunitet.

Duke e vendosur shtimin e vlerës së jetës kulturore dhe sociale të Shqipërisë si një nga përparësitë e saj, BKT ofron mbështetje për arsimin, aktivitetet akademike, aktivitetet kulturore dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në vitin 2010, prioriteti i BKT-së në fushën e përgjegjësisë sociale ishte arsimi. Në këtë kuadër, BKT ka sponsorizuar programe arsimore dhe ka stimuluar studentët më të mirë me bursa vjetore. Rëndësi e veçantë i jepet studentëve të financës dhe të ekonomikut.

BKT është partnere në zhvillimin e programeve Master në Universitetin e Tiranës dhe ka sponsorizuar krijimin e fondit të bibliotekës së universitetit.



BKT ofron mbështetje për arsimin, aktivitetet akademike, kulturore dhe mbrojtjen e mjedisit.



BKT punëson personelin e duhur për pozicionin e duhur dhe i kushton një rëndësi shumë të madhe sigurimit të zhvillimit të vazhdueshëm të punonjësve të saj nëpërmjet programeve të trajnimit.



Burimet Njerëzore

BKT punëson njerëz me kualifikime të larta personale dhe profesionale dhe krijon një skuadër të fortë që zbaton kulturën korporative të Bankës.

BKT e konsideron krahun e saj të punës si shumë të kualifikuar, me vlera të larta dhe si aset in e saj më të vyer. Duke u përpjekur gjithmonë të rrisë në maksimum performancën, BKT merr në punë personin e duhur për vendin e duhur të punës dhe i kushton rëndësi të madhe sigurimit të zhvillimit të vazhdueshëm të punonjësve të saj nëpërmjet programeve të trajnimit.

Në vitin 2010, BKT vazhdoi trajnimin për punonjësit e saj. Çdo person i punësuar në BKT është trajnuar 6.8 ditë në formën e trajnimit në bankë, në seminareve dhe trajnime të jashtme.

Pavarësisht nga rritja e njësive të rrjetit, rritja e numrit të stafit është mbajtur në minimum në vitin 2010, ndërsa Programi jo efektiv i Mbështetjes së Personelit u transformuar në Politika e Planit të Investimit të Personelit, i cili u prit shumë më mirë nga punonjësit. Në vitin 2010, BKT ka miratuar dhe modulën SAP të Burimeve Njerëzore.

BKT është sponsori kryesor i një projekti që ka pasur një vend të rëndësishëm në politikën e rekrutimit gjatë 3 viteve të fundit.

I emërtuar si "Programi i Studimit FASTIP" në Fakultetin e Studimeve të Integruara të Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës, ky projekt prezanton një bashkëpunim novativ ndërmjet sektorit bankar dhe institucioneve arsimore. Duke ndjekur këtë iniciativë, BKT është e angazhuar të japë bursa për studentët e Menaxhimit Bankar gjatë viteve akademike 2008-2011.

Nëpërmjet këtij projekti, studentët pajisen me praktika pune që ndihmojnë në integrimin e njohurive akademike me praktikën bashkëkohore profesionale dhe mundësitë e punësimit pas diplomimit të tyre.

Programi financoi 15 studentë vitin e parë, 25 në vitin e dytë dhe 22 në vitin 2010. Të diplomuarit e parë nga ky program do të dalin në vitin 2011. Duke trajnuar personelin që do të marrë në punë, BKT planifikon të marrë në punë 100% të të gjithë të diplomuarve që marrin pjesë në këtë projekt.



BKT e konsideron krahun e saj të punës si shumë të kualifikuar, me vlera të larta dhe si aset in e saj më të vyer.



Në vitin 2010, BKT vijoi trajnimin e personelit; çdo punonjës mori 6.8 ditë trajnim.



Në periudhën në vijim, BKT ka si synim të përdorë kompetencat e saj të biznesit, njohuritë dhe eksperiencën e saj dhe të skuadrës së saj prej profesionistësh si avantazhet e saj më konkurruese ndërsa vazhdon të ndjekë rritjen dhe zhvillimin në të gjitha linjat e biznesit.



Perspektiva për vitin 2011

Në vitin 2011 BKT parashikon një rritje prej 27% të bilancit të saj, në mënyrë që totali i aktivitetit të tejkalojë 1.9 miliardë dollarë. Ndërkohë që totali i depozitave do të rritet përpjestueshmërisht me 26%, rritja e planifikuar në totalin e huave është shumë më agresive – 45%.

Fitimi i synuar neto prej 36 milionë dollarësh do të përkohet me kthimin mbi kapitalin në masën 30% dhe do t'a çojë kapitalin aksioner në 155 milionë dollarë.

Numri gjithsej i degëve do të jetë 80 në fund të vitit, pas hapjes së shtatë degëve të reja, katër në Shqipëri dhe tre në Kosovë.

Në vitin 2011;

Grupi i Bankingut Individual do të shesë më shumë produkte bankingu individual dhe për këtë qëllim do të krijohet dhe një Departament për Shitjet për Individët. Grupi planifikon të zerë 16% pjesës së tregut për huatë për individët dhe 10% në bizneset që përdorin POS, ndërsa planifikon të dyfishojë numrin e kartave të kreditit në 20,000.

Grupi i Bankingut të Korporatave do të nisë punën për të krijuar Komitetin Kombëtar të ICC-së në Shqipëri dhe synon të rrisë huadhënien për bizneset me 39%.

Grupi i Bankingut Tregtar do të vazhdojë të jetë lojtar aktiv në programet e sektorit publik/të lidhura me qeverinë dhe synon rritjen e kredidhënies tregtare me 47%.



Në vitin 2011 Grupi i Shërbimit Bankar për Individët do të shesë më shumë produkte për individët.

Grupi i Thesarit dhe i Institucioneve Financiare do të kontribuojë në fitimin e bankës duke rritur kthimin mesatar mbi likuiditetin e FX në 5%, ndërsa do të rrisë po ashtu dhe njohjen dhe kredibilitetin ndërkombëtar të Bankës.

Grupi i Menaxhimit të Riskut do të vazhdojë të përqendrohet në uljen e NPL-së, duke synuar arritjen në 5%, objektivi i cili do të arrihet nëpërmjet punës së vazhdueshme rimëkëmbëse.

Grupi i Operacioneve do të përqendrohet në gjetjen e personelit të duhur për degët e reja si dhe për agjencitë e përmirësuara, ndërsa do të intensifikojë trajnimin e stafit, duke ofruar 7 ditë trajnimi në vit për çdo të punësuar. 2011 është viti i parë i diplomimit të studentëve të programit FASTIP, të cilët do të merren të gjithë në punë. Grupi do të përfundojë gjithashtu dhe miratimin e një sistemi për menaxhimin e dokumenteve dhe modulit të menaxhimit të materialeve të SAP.

Divizioni i Kontrollit, Planifikimit dhe Raportimit Financiar do të vazhdojë të ofrojë kontrollin e duhur, ndërkohë që do të ofrojë informacione të duhura dhe të saktë palëve të përfshira. Divizioni do të përqendrohet në automatizimin e procesit të buxhetit vjetor dhe në matjen më të mirë të përfitueshmërisë së degës.

Divizioni i Rrjetit do të rivendosë tri degë në ndërtesat e Albtelecom-it për të krijuar kursime në bazë Grupi. Dega kryesore do të jetë dega e vetme e korporatave dhe thuhet të gjitha agjencitë do të marrin statusin e degës si në lidhje me funksionalitetin ashtu edhe me personelin.



Në vitin 2010 numri gjithsej i degëve do të shkojë në 80 deri në fund të vitit pas hapjes së shtatë degëve të tjera, katër në Shqipëri dhe tre në Kosovë.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(me raportin e audituesve të pavarur bashkëngjitur)

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Përmbajtja	Faqe
RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR	i - ii
PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA:	
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE PËRMBLEDHËSE	2
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN E VET	3-4
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË PARAVE	5
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA	6 – 61

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

RAPORTI I PAVARUR I AUDITORIT



KPMG Albania Sh.p.k
"Deshmoret e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania
NIPT J91619001D

Telephone +355 (4) 2274 524
+355 (4) 2274 534
Telefax +355 (4) 2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Aksionerit dhe drejtuesve të
Banka Kombetare Tregtare Sh.a.

Tiranë, 9 shkurt 2011

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a. ("Banka"), të cilat përbëhen nga pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2010, pasqyra e konsoliduar e të ardhurave përmblëdhëse, pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin e vet dhe pasqyra e konsoliduar e flukseve të parave për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmblëdhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare të konsoliduara nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të konsoliduara në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenceja e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë me rezervë.

KPMG Albania, an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International Cooperative ("KPMG International"), a Swiss entity.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

RAPORTI I PAVARUR I AUDITORIT



Baza për Opinion me Rezervë

Siç është trajtuar në Shënimin 3 (b) të pasqyrave financiare të konsoliduara, Banka e ka trajtuar kapitalin aksionar të emetuar në USD si një zë monetar dhe e ka njohur diferencën prej rivlerësimit të tij gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2010, në fitimin neto në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave përmbledhëse. Ky trajtim nuk është në përputhje me SNK 21 "Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit Valutor". Ky trajtim është rezultat i një vendimi të marrë nga drejtimi përpara fillimit të vitit financiar paraardhës dhe ka shkaktuar dhënie të opinionit me rezervë nga ana jonë, mbi pasqyrat financiare të konsoliduara të atij viti. Kapitali aksionar duhet të ishte trajtuar si zë jomonetar dhe të mbahej me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Për pasojë, nëse kapitali aksionar do të ishte trajtuar si një zë jomonetar, fitimi neto për vitin do të ishte rritur me 6,212,180 USD në vitin 2010 dhe me 4,832,998 USD në vitin 2009, fitimet e pashpërndara do të ishin rritur dhe rezerva e rivlerësimit do të ishte ulur me 2,334,950 USD më 31 dhjetor 2010 dhe fitimet e pashpërndara do të ishin ulur dhe rezerva e rivlerësimit do të ishte rritur me 5,475,088 USD më 31 dhjetor 2009. Kjo nuk do të kishte efekt në totalin e kapitalit të vet.

Opinion me rezervë

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efektit në pasqyrat financiare të konsoliduara, të çështjes së trajtuar në paragrafin Baza për Opinion me Rezervë, pasqyrat financiare të konsoliduara japin një pamje të drejtë dhe të sigurtë, të gjendjes financiare të konsoliduar të Bankës më 31 dhjetor 2010, rezultatit të saj financiar të konsoliduar dhe flukseve të saj të konsoliduara të parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG Albania Shpk

KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmoret e Kombit" Bivù.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD)

Aktivitet	Shënime	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Aktivitet			
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	7	177,385,066	142,263,329
Depozita dhe llogaritë me bankat	8	113,703,073	132,642,747
Bono thesari	9	187,826,686	255,640,833
Investime të vlefshme për shitje	10	101,714,745	49,520,063
Investime të mbajtura deri në maturim	11	275,915,418	194,965,671
Hua dhe paradhënie për bankat	12	68,810,445	45,487,888
Hua dhe paradhënie për klientët	13	551,045,870	494,271,286
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	14	16,475,450	19,371,484
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	15	1,610,738	1,518,375
Aktive afatgjata që mbahen për t'u shitur	16	5,206,635	1,297,477
Aktive të tjera	17	3,207,420	3,062,500
Totali i aktiveve		1,502,901,546	1,340,041,653
Detyrimet dhe kapitali aksionar			
Detyrimet			
Detyrime ndaj klientëve	18	1,309,651,520	1,167,146,858
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	19	62,398,988	69,175,055
Detyrime ndaj palëve të treta	20	2,151,892	456,415
Detyrime tatimore të shtyra	21	1,731,801	736,954
Detyrime të tjera	22	8,297,498	7,855,717
Totali i detyrimeve		1,384,231,699	1,245,370,999
Kapitali aksionar			
Kapitali i aksionar i paguar	23	84,622,200	78,299,000
Rezerva e rivlerësimit	23	(34,349)	(209,293)
Rezerva e vlerës së drejtë	23	342,874	56,674
Fitimi i pashpërndarë	23	33,739,122	16,524,273
Totali i kapitalit aksionar		118,669,847	94,670,654
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar		1,502,901,546	1,340,041,653

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyrat financiare të konsoliduara u autorizuan nga Këshilli Drejtues më 25 Janar 2011 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Seyhan Pencapligil
Drejtor i Përgjithshëm dhe
Anëtar i Këshillit Drejtues



Skënder Emini
Drejtor i Kontrollit Financiar

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Të ardhura nga interesi	24	104,360,345	84,214,614
Shpenzime interesi	25	(49,672,970)	(46,397,055)
Të ardhura nga interesi, neto		54,687,375	37,817,559
Të ardhura të tjera neto nga veprimtaria bankare			
Tarifa dhe komisione, neto	26	4,426,426	4,233,457
Fitimi neto nga rivlerësimi i valutave	27	1,286,830	3,004,781
Fitimi neto nga këmbimet valutore		1,843,633	2,110,796
Të ardhura/(shpenzime) të tjera, neto	28	(297,222)	(143,777)
Totali i të ardhurave të tjera neto nga veprimtaria bankare		7,259,667	9,205,257
Shpenzime operative			
Shpenzime personeli	29	(12,335,056)	(11,906,608)
Shpenzime administrative	30	(15,749,247)	(13,389,296)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	14,15	(4,280,684)	(4,095,583)
Totali i shpenzimeve operative		(32,364,987)	(29,391,487)
Zhvlerësimi i huave	13	(1,643,974)	(3,068,156)
Fitimi para tatimit		27,938,081	14,563,173
Tatimi mbi fitimin	31	(2,935,112)	(1,519,588)
Fitimi neto i vitit		25,002,969	13,043,585
Diferenca konvertimi të monedhave të huaja		174,944	620,662
Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së drejtë		286,200	255,557
Të ardhura të tjera përmbledhëse për vitin, neto pas tatimit		461,144	876,219
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin		25,464,113	13,919,804

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave përmbledhëse duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin e vet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD)

Kapitali aksionar i paguar	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitimi i pashpërndarë	Totali
63,400,000	(829,955)	(198,883)	21,483,347	83,854,509
14,899,000	-	-	(14,899,000)	-
-	-	-	(829,955)	(829,955)
-	-	-	(2,273,704)	(2,273,704)
14,899,000	-	-	(18,002,659)	(3,103,659)
-	-	-	13,043,585	13,043,585
-	-	255,557	-	255,557
-	620,662	-	-	620,662
-	620,662	255,557	-	876,219
-	620,662	255,557	13,043,585	13,919,804
78,299,000	(209,293)	56,674	16,524,273	94,670,654

Gjendja më 1 Janar 2009

Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në kapital

Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët

Rritja e kapitalit të paguar

Kthimi i diferencave të rivlerësimit të vitit 2008

Rregullimi i fitimit të pashpërndarë me kursin e fund vitit 2009

Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët

Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin

Fitimi neto i vitit

Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto pas tatimit

Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së drejtë

Diferenca konvertimi të monedhave të huaja

Totali i të ardhura të tjera përmbledhëse

Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin

Gjendja më 31 Dhjetor 2009

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin e vet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD)

Gjendja më 1 Janar 2010

Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në kapital

Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët

Rritja e kapitalit të paguar

Kthimi i diferencave të rivlerësimit të vitit 2009

Rregullimi i fitimit të pashpërndarë me kursin e fund vitit 2010

Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët

Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin

Fitimi neto i vitit

Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto pas tatimit

Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së drejtë

Diferenca konvertimi të monedhave të huaja

Totali i të ardhura të tjera përmbledhëse

Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin

Gjendja më 31 Dhjetor 2010

Kapitali aksionar i paguar	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitimi i pashpërndarë	Totali
78,299,000	(209,293)	56,674	16,524,273	94,670,654
6,323,200	-	-	(6,323,200)	-
-	-	-	(209,293)	(209,293)
-	-	-	(1,255,627)	(1,255,627)
6,323,200	-	-	(7,788,120)	(1,464,920)
-	-	-	25,002,969	25,002,969
-	-	286,200	-	286,200
-	174,944	-	-	174,944
-	174,944	286,200	-	461,144
-	174,944	286,200	25,002,969	25,464,113
84,622,200	(34,349)	342,874	33,739,122	118,669,847

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapitalin e vet duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Pasqyra e konsoliduar e flukseve të parave për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Flukset e parave nga aktivitetet operacionale:			
Fitimi para tatimit		27,938,081	14,563,173
Rregullime për të rakorduar ndryshimet në aktivet neto me fluksin neto të parave nga aktivitetet operacionale:			
Shpenzime interesi	25	49,672,970	46,397,055
Të ardhura nga interesi	24	(104,360,345)	(84,214,614)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	14, 15	4,280,684	4,095,583
Fitimi nga shitja e aktiveve të trupëzuara		(21,314)	(3,411)
Fitimi nga shitja e bonove të thesarit		(84,253)	(37,210)
Fitimi nga arkëtimi i kredive të humbura		(31,340)	(18,307)
Nxjerrje jashtë përdorimit e aktiveve të trupëzuara		5,498	1,942
Nxjerrje jashtë përdorimit e inventarit të imët		500	-
Humbje nga kreditë e humbura të pakthyeshme		185,425	211,270
Provizione për debitorë të tjerë		429,874	-
Lëvizje në rezervën e vlerës së drejtë		290,859	(241,349)
Aktive tatimore të shtyra	21	1,053,591	588,760
Zhvlerësimi i huave	13	1,643,974	3,068,156
Flukset e parave nga fitimet operacionale para ndryshimeve në aktive dhe detyrime operacionale		(18,995,796)	(15,588,952)
(Rritja)/ Pakësimi i aktiveve operacionale:			
Llogaritë e kufizuara me bankën qendrore		(12,612,177)	(12,436,479)
Depozita dhe llogari me bankat		(96,211,993)	107,538,248
Hua dhe paradhënie për bankat		(26,626,774)	(45,748,750)
Hua dhe paradhënie për klientët		(94,767,017)	(142,453,180)
Aktive të tjera		(4,579,816)	(718,934)
		(234,797,777)	(93,819,095)
Rritja/ (Pakësimi) i detyrimeve operacionale:			
Detyrime ndaj klientëve		232,418,730	205,493,218
Detyrime ndaj palëve të treta		1,732,586	(549,799)
Detyrime të tjera		(350,066)	1,836,548
		233,801,250	206,779,967
Interesi i paguar		(47,464,286)	(44,425,045)
Interesi i arkëtuar		97,604,982	80,751,507
Tatimi fitimi i paguar		(1,743,779)	(1,560,648)
Flukset neto të parasë nga aktivitetet operacionale		28,404,594	132,137,734
Flukset e parave nga aktivitetet investuese			
Blerje e investimeve		(148,555,173)	(69,185,677)
(Shitje)/ Blerje e bonove të thesarit		108,416,537	(60,664,591)
Blerje e aktiveve të trupëzuara		(3,150,165)	(6,747,489)
Hyrje nga shitja e aktiveve të trupëzuara		44,672	1,944
Hyrje nga shitja e bonove të thesarit		12,944,904	16,887,727
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		(30,299,225)	(119,708,086)
Flukset e parave nga aktivitetet financuese			
(Shlyerje)/hyrje nga huatë afatshkurta		(1,381,476)	49,787,950
Paraja neto (e përdorur)/e gjeneruar prej aktiviteve financuese		(1,381,476)	49,787,950
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		(3,276,107)	62,217,598
Diferencat në kursin e këmbimit		(5,052,312)	(6,360,244)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	7	149,681,223	93,823,869
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	7	141,352,804	149,681,223

Pasqyra e konsoliduar e flukseve të parave duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

1. Të përgjithshme

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a. është një bankë tregtare që ofron një gamë të gjerë me shërbime të plota. Pasqyrat e konsoliduara financiare përfshijnë Bankën dhe degën e saj në Kosovë (referuar së bashku në vazhdim si "Banka", ose "BKT").

Banka ofron shërbime bankare për ndërmarrje shtetërore e private dhe individë. Burimi kryesor i fondeve për Bankën janë depozitat, të cilat Banka i pranon në forma të ndryshme duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, depozita me dhe pa afat, si në Lek ashtu edhe në valutë. BKT ofron: një shumëllojshmëri të kredive për biznese dhe individë, karta krediti dhe debiti në përputhje me standartin EMV, bankomate, bankingu në internet, bankingu në telefon celular, shërbime bankingu on-line, shërbim të kualifikuar të bankingut ndërkombëtar dhe produkte të ndryshme thesari. Gjithashtu, ajo investon në letra me vlerë dhe merr pjesë aktivisht në tregun ndërbankar lokal dhe ndërkombëtar.

BKT është krijuar në formën aktuale ligjore më 30 Dhjetor 1992, megjithëse dega e saj e parë është hapur në 30 Nëntor 1925. BKT është subjekt i Ligjit nr. 8269 "Mbi Bankën e Shqipërisë" me datë Dhjetor 1997 dhe i Ligjit nr. 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", të datës 18 Dhjetor 2006.

Banka, në bazë të vendimit të mbledhjes së Aksionerëve të marrë në datën 31 Mars 2010, rriti kapitalin e saj të paguar me shumën 6,323,000 USD (ekuivalenti në Lek 653,249,792), duke përdorur një pjesë të fitimit të saj të pashpërndarë nga viti 2009. Rritja e kapitalit u konvertua në USD me kursin e këmbimit të deklaruar nga Banka e Shqipërisë për datën 31 Mars 2010 (1USD=103.31 Lek).

Pas kësaj rritjeje të kapitalit, struktura e aksionerëve nuk pësoi ndryshim, sikurse dhe vlera nominale e aksioneve në vlerën 12.35 USD / aksion, ndërkohë që numri i aksioneve u rrit me 512,000. Struktura e aksionerëve në datë 31 Dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009 është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010			31 Dhjetor 2009		
	No. i aksioneve	Totali USD	%	No. i aksioneve	Totali USD	%
Çalik Finansal Hizmetler A.S.	6,852,000	84,622,200	100	6,340,000	78,299,000	100

Drejtorja e Përgjithshme e BKT ndodhet në Tiranë. Aktualisht në Shqipëri, Banka zotëron një rrjet prej 27 degë, 27 agjenci dhe 3 agjenci doganore. Njëmbëdhjetë prej degëve ndodhen në Tiranë dhe të tjerat në Durrës, Elbasan, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë, Lushnjë, Shkodër, Fier, Berat, Pogradec, Sarandë, Lezhë, Kukës, Peshkopi, Fushë Krujë dhe Kavajë. Në të njëjtën mënyrë, edhe shumica e agjencive janë në Tiranë (tetë prej tyre), ndërsa të tjerat ndodhen në Kamëz, Vorë, Elbasan, Bilisht, Delvinë, Laç, Rrëshen, Shkodër, Bushat, Koplik, Librazhd, Peqin, Rrogozhinë, Shkozë, Durrës (2 agjenci), Orikum, Kuçovë dhe Fier, të ndjekura nga agjencitë doganore në Kakavijë, Portin e Durrësit dhe Aeroportin e Rinasit. Gjatë vitit 2010, Banka hapi katër agjenci të reja në Shqipëri, ndërkohë që u mbyll një agjenci doganore dhe dy degë u bashkuan.

BKT zotëron një degë në Kosovë, e cila në fund të vitit 2009 kishte një rrjet prej 12 njësisish, ndërkohë që gjatë vitit 2010 u hapën edhe 3 njësi të tjera, duke e çuar numrin total në 15. Pesë njësi ndodhen në Prishtinë, ndërsa të tjerat janë të vendosura në Prizren, Pejë, Ferizaj, Podujevë, Gjilan, Drenas, Rahovec, Gjakovë, Lipjan dhe Vushtrri.

Banka kishte 922 punonjës (2009: 854) në datën 31 Dhjetor 2010, nga të cilët 171 (2009: 129) i përkasin Degës së Kosovës.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ('SNRF') të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK').

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në koston historike përveç instrumenteve financiare të mbajtura për shitje, të cilat janë matur me vlerën e drejtë dhe aktivet afatgjata të mbajtura për shitje, të cilat janë matur me vlerën më të vogël të vlerës së mbetur dhe vlerës së drejtë, duke i zbritur koston.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në USD. Monedha funksionale e Bankës është Lek.

Banka ka zgjedhur ti prezantojë pasqyrat financiare në USD, meqë kapitali i saj është i zotëruar plotësisht nga investitorët ndërkombëtarë, të cilët kanë kontribuar kapitalin fillestar në USD dhe e vëzhgojnë performancën e investimit në USD.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën çmuarja rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Informacioni mbi elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare jepet në shënimet 4 dhe 5.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare të konsoliduara, dhe janë aplikuar në mënyrë të njëjtë nga njësitë e Bankës.

(a) Baza e konsolidimit

(i) Filialet

Filialet janë njësi të kontrolluara nga Banka dhe përfshijnë degët e huaja. Kontrolli ekziston atëherë kur Banka ka fuqinë të drejtë të drejtojë politikave financiare dhe operacionale të një njësie, me qëllim që të përfitojë nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit, merren në konsideratë të drejtat potenciale votuese që janë aktualisht në fuqi. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira tek pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të kontrollit deri në datën e mbarimit të tij. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në politika kontabël uniforme për transaksione të ngjashme dhe çështje të tjera në kushte të njëjta.

Në datën 3 Shtator 2007, BKT hapi degën e saj të parë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyra Administrative e kësaj dege u hap në qytetin e Prishtinës, Kosovë.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(a) Baza e konsolidimit (vazhdim)

(ii) Transaksionet e eliminuara gjatë konsolidimit

Tepricat brenda grupit, dhe ndonjë shumë e perealizuar e të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga transaksionet brenda grupit, janë eliminuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Fitimet e perealizuara janë eliminuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e perealizuara janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e perealizuara, por deri në masën që nuk ka evidencë për rënie të vlerës.

(b) Monedha të huaja

(i) Transaksionet në monedhë të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj janë kthyer me kursin e këmbimit në datën kur është kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare, të shprehura në monedhë të huaj janë kthyer në monedhën funksionale, me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi apo humbja prej instrumenteve monetare, është ndryshimi midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar kjo për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale, me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare, në monedhë të huaj, që maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Ndryshimet që rrjedhin nga ndryshimi i kursit të këmbimit të valutave janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të cilat shprehen me kosto historike, këmben me kursin e datës së transaksionit, me përjashtim të kapitalit aksionar të paguar, i cili është emetuar dhe mbahet në USD sipas legjislacionit në Shqipëri, dhe në veçanti në përputhje me Ligjin nr. 8634, datë 6 Korrik 2000, pas marrëveshjes ndërmjet aksionerëve të Bankës dhe Republikës së Shqipërisë mbi privatizimin e Bankës.

Për me tepër, Rregullorja e Operacioneve të Bankës kërkon që Kapitali i aksionar i paguar të mbrohet nga aktivet në USD, dhe është i trajtuar si një zë monetar, me diferencën e rivlerësimit të kaluar në fitim/humbje së bashku me diferencën e rivlerësimit të aktivitetit korrespondues në USD, të cilat kompensojnë njëra-tjetrën në një mënyrë të natyrshme.

(ii) Operacionet e huaja

Aktivitet dhe detyrimet janë të kthyera në Lek me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Të ardhurat dhe shpenzimet janë të kthyera në Lek me kursin e datës së transaksionit. Diferencat e kursit të këmbimit që lidhen me kthimin e operacioneve të huaja, janë njohur direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse. Këto diferencat janë njohur në rezervën e rivlerësimit.

(iii) Përkthimi i pasqyrave financiare nga monedha funksionale në monedhën e prezantimit

Përkthimi i pasqyrave financiare nga monedha funksionale në monedhën e prezantimit është si më poshtë:

- aktivet dhe detyrimet në datën e raportimit (duke përfshirë komperativin) janë kthyer me kursin e mbylljes në datën e raportimit.
- të ardhurat dhe shpenzimet (duke përfshirë komperativin) janë kthyer me kurset e datës së transaksioneve.
- Zërat e kapitalit përveç fitimit neto dhe kapitalit të paguar dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse janë kthyer me kursin e mbylljes në datën e raportimit.
- Kapitali i aksionar i paguar është kthyer siç është përshkruar në paragrafin 3(b),(i) më sipër.
- Të gjitha diferencat prej kursit të këmbimit janë njohur si një komponent i vecantë i kapitalit në llogarinë e rezervës së rivlerësimit.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Monedha të huaja (vazhdim)

(iv) Transaksionet "spot" në monedhë të huaj

Banka, gjatë veprimtarisë normale të biznesit ndërmerr transaksione në monedhë të huaj "spot", për të cilat data e marrëveshjes është 1 ose 2 ditë pas datës së tregtimit. Këto transaksione janë regjistruar në pasqyrat financiare në datën e marrëveshjes. Diferencat në monedhë të huaj njihen në fitim/humbje në datën e marrëveshjes.

(c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivit ose detyrimit financiar deri në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar. Kur llogaritet normën e interesit efektiv, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet dhe pikët e paguara apo të arkëtuara që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

(d) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

(e) Pagesat e qirasë

Pagesat e kryera për qiranë operative janë ngarkuar në fitim ose humbje në mënyre lineare gjatë periudhës së qirasë. Pagesat motivuese njihen si pjesë përbërëse e shpenzimit të qirasë përgjatë jetës së qirasë.

Detyrimet e kushtëzuara për pagesat e qirasë llogariten duke rishikuar pagesat e ardhshme minimale përgjatë jetës së mbetur të qirasë kur konfirmohen ndryshime të qirasë.

(f) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe ai i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera përmbledhëse. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Tatim fitimi (vazhdim)

Tatimi i shtyrë është njohur për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e mëposhtme: njohjen fillestare të emrit të mirë, njohjen fillestare të aktiveve apo detyrimeve në një transaksion që nuk është kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as fitim/humbjen kontabël dhe as atë të tatueshme, dhe diferenca lidhur me investimet në filiale në masën që ato nuk do t'i kthejnë këto në të ardhmen. Tatimi i shtyrë është matur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të realizohet, në mënyrë që ato të mund të përdoren kundrejt tij. Aktiviteti tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet nëse nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal. Të ardhura të tjera të tatueshme që vijnë nga shpërndarja e dividendëve, njihen në të njëjtën kohë kur njihet edhe detyrimi për të paguar dividendin.

(g) Aktivitetet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh huatë dhe depozitat në datën kur ato krijohen. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë njohur në datën e tregtimit në të cilën Banka zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Të gjitha aktivitetet e detyrimeve të tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, në të cilën Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar është matur fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e tij.

(ii) Klasifikimi

Referoju politikave kontabël 3(h), (i) dhe (j).

(iii) Mosnjohja

Banka nuk njeh një aktiv financiar, kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur ajo e transferon aktivin financiar në një transaksion ku të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivitetit financiar janë transferuar. Ndonje interes mbi aktivitetet financiare të transferuara që plotësojnë kushtet për mosnjohje, i cili është krijuar apo përfituar nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë. Banka nuk njeh një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale përfundojnë, anulohen ose i mbaron afati.

Banka merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar ose një pjesë të tyre. Nëse ruhen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet, atëherë aktivitetet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve ku ruhen thuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve.

Kur aktivitetet i shiten një palë të tretë me një normë totale kthimi në këmbeje të aktiveve, transaksioni konsiderohet si një transaksion financiar i siguruar, i ngjashëm me transaksionet e riblerjes.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivët dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Mosnjohja (vazhdim)

Në transaksionet ku Banka as nuk ruan dhe as nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar, Banka cregjistron aktivin kur ajo nuk mban kontrollin mbi aktivin. Të drejtat dhe detyrimet që mbahen pas transferimit njihen vecant si aktiv apo detyrim, sipas rastit. Në trasnferta ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin, në masën e përfshirjes së saj në vazhdim, që përcaktohet nga masa në të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimit të vlerës së aktivit të transferuar.

Në disa transaksione Banka mban detyrimin për ti shërbyer aktivit financiar të transferuar për një tarifë. Aktivi i transferuar përfundon së njohuri tërësisht kur plotesohen kriteret e mosnjohjes. Një aktiv apo detyrim përfundon së njohuri për kontratën e shërbimit, duke u varur nga fakti nëse tarifa e shërbimit është më se e përshtatshme (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme (detyrim) për kryerjen e shërbimeve. Banka bën fshirjen e kredive dhe investimeve që janë të paarkëtueshme.

(iv) Netimi

Aktivët financiare mund të netohen me detyrimet financiare dhe vlera e tyre neto të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten mbi baza neto vetëm kur lejohen nga SNRF-të, ose për fitime dhe humbje të lindura nga një grup transaksionesh të ngjashme si në rastin e aktiviteteve tregtare të Bankës.

(v) Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e këstit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një aktiv mund të shkëmbehet, ose një detyrim mund të shlyhet, midis palëve të mirëinformuara dhe me vullnet të plotë në kushte të lira tregu në datën e matjes.

Banka e llogarit vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmime të kuotuar në një treg aktiv për atë instrument, në rast se keto janë të disponueshme. Një treg quhet aktiv në qoftë se çmimet e kuotuar janë rregullisht të gatshëm dhe paraqesin transaksionet aktuale të vazhdueshme në kushte të lira tregu.

Në qoftë se për një instrument financiar nuk ka treg aktiv, Banka vendos vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të kryera midis palëve të vullnetshme, të mirë informuara dhe të palidhura me njëra-tjetrën (nëse ka të tilla), krahasime me vlerën e drejtë për instrumente të tjerë të ngjashëm, dhe analizat e fluksit monetar të skontuar. Teknika e vlerësimit e zgjedhur përdor maksimumin e inputeve të tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në inputet specifike të Bankës. Ajo përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në caktimin e çmimit dhe është në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për vlerësimin e instrumenteve financiare. Inputet për teknikat e vlerësimit pasqyrojnë në mënyrë të arsyeshme pritshmërinë e tregut dhe matjet e faktorëve të rrezikut të kthimit, të qenësishëm në instrumentin financiar. Banka rishih teknikën e vlerësimit dhe e teston atë për vlefshmëri, duke përdorur çmime nga transaksione aktuale të mbikëqyrura lidhur me të njëjtin instrument, ose bazuar në të dhënat e disponueshme e të mbikëqyrura në treg. Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është çmimi i transaksionit, p.sh vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë, me përjashtim të rasteve kur vlera e drejtë e këtij instrumenti gjendet duke bere krahasime me transaksione të tjera, të vezhguara në treg për të njëjtin instrument, ose bazohet në një teknikë vlerësimi, variablat e të cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregje të vezhguara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivët dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vi) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

Kur çmimi i transaksionit ofron evidencën më të mirë për vlerën e drejtë për njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me çmimin e transaksionit dhe ndonjë diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës së përfutur fillimisht nga një model vlerësimi, njihet në vijim në fitim ose humbje gjatë jetës së instrumentit, varësisht nga faktet e rrethanat individuale të transaksionit, por jo më vonë se atëherë kur vlerësimi mund të mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhguara në treg, ose kur transaksioni mbyllet.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen nëse evidenca objektive tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja e zhvlerësimit ka një ndikim në flukset e ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijë mospagesa ose vështirësi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një huaje me kushte dhe afate të cilat Banka nuk do t'i kishte dhënë ndryshe, të dhëna që një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një investim, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh ndryshime të pafavorshme në aftësinë paguese të një huamarrësi ose emetuesi të letrave me vlerë, ose kushte ekonomike që lidhen me paaftësi për të paguar Bankën. Nëse ka një rënie të konsiderueshme të vlerës së drejtë kundrejt kostos së investimeve në kapital, kjo është një evidencë objektive zhvlerësimi.

Banka konsideron evidencën e zhvlerësimit për huatë dhe paradhëniet dhe investime të mbajtura deri në maturim si individualisht ashtu edhe në mënyrë kolektive. Të gjitha huatë dhe paradhëniet dhe investimet e mbajtura deri në maturim të cilat janë individualisht të rëndësishme, vlerësohen individualisht për zhvlerësim specifik. Për investimet e huatë, për të cilat nuk ka tregues të rënies në vlerë, kryhet një rishikim i tyre në grup për zhvlerësim, që ka ndodhur, por nuk është identifikuar ende. Të gjitha huatë dhe paradhëniet dhe investimet e mbajtura deri në maturim, të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme, vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim duke grupuar së bashku huatë dhe paradhëniet dhe investimet e mbajtura deri në maturim që kanë karakteristika të ngjashme rreziku.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme, të vlerësuara të mjeteve monetare, skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provizionit përkundrejt huave dhe paradhënieve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pas datës së raportimit tregon për zvogëlim të zhvlerësimit, zvogëlimi i zhvlerësimit anulohet nëpërmjet fitimit ose humbjes. Humbja nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të mbajtura për shitje njihet duke transferuar humbjen kumulative, e cila është njohur direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse të fitim/humbjes.

Humbja kumulative që është riklasifikuar nga të ardhura të tjera përmbledhëse është diferenca ndërmjet kostos së blerjes, së cilës i është zbritur ndonjë ripagim kësti dhe amortizimi, dhe vlerës së drejtë aktuale duke i zbritur zhvlerësimin që është njohur më parë në fitim/humbje.

Ndryshimet në provizion që i atribuohen vlerës së kohës, janë reflektuar si një komponent i të ardhurave nga interesi. Nëse, në një periudhë të ardhme, vlera e drejtë e një letre me vlerë të vlefshme për shitje të zhvlerësuar më parë rritet, dhe rritja mund të lidhet me një ngjarje të ndodhur pas humbjes nga zhvlerësimi i cili ishte njohur në fitim/humbje, kjo humbje nga zhvlerësimi kthehet mbrapsht nëpërmjet fitim/humbjes.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(h) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, gjendje të pakushtëzuara në Bankën Qendrore dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë të drejtë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar.

(i) Hua dhe paradhënie

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhën afatshkurtër.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme ("marrëveshje të anasjella të riblerjes"), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Bankës.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të transaksionit, dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç rastit kur Banka zgjedh të mbajë huatë dhe paradhëniet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim/humbjes siç përshkruhet në politikat kontabël (g),(vi).

(j) Investime

Investimet njihen fillimisht me vlerë të drejtë, dhe në rastin e letrave me vlerë jo nëpërmjet fitim/humbjes, plus kostot e transaksioneve direkte, dhe për pasojë regjistrohen në varësi të klasifikimit në të mbajtura deri në maturim, ose të vlefshme për shitje.

(i) Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet që mbahen deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të përcaktuar, të cilat Banka ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje.

Investimet që mbahen deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Në rastet e shitjes ose riklasifikimit përpara maturimit të një sasive të rëndësishme të investimeve që mbahen deri në maturim, do të rezultonte në riklasifikimin e të gjithë investimeve që mbahen deri në maturim në kategorinë e vlefshme për shitje, dhe kjo do ta pengonte Bankën të klasifikonte investimet si të mbajtura deri në maturim, gjatë periudhës aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasues.

(ii) Investime të vlefshme për shitje

Investime e mbajtura për tregtim janë instrumente jo-derivative të cilat janë klasifikuar si të mbajtura për shitje ose nuk janë klasifikuar si ndonjë kategori tjetër e aktiveve financiare. Investimet e mbajtura për tregtim mbahen me vlerën e drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim/humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimi ose humbja nga investime të mbajtura për shitje njihet në fitim/humbje.

Ndryshime të tjera në vlerën e drejtë njihen direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse deri në momentin që investimi shitet ose zhvlerësohet, moment kur humbjet ose fitimet kumulative të njohura më parë në të ardhura të tjera përmbledhëse, njihen në fitim/humbje.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivit.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese a të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të elementit, nëse është e mundshme që Banka në të ardhmen të ketë përfitime ekonomike, që i atribuohen atij elementi, dhe nëse kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar cregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo zëri të aktiveve afatgjata të trupëzuara. Toka nuk zhvlerësohet.

Vlerësimi për jetën e dobishme për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si më poshtë:

• Ndërtesa dhe përmirësime të ambjenteve me qira	20 vite
• Mjete transporti dhe pajisje të tjera	5 vite
• Pajisje zyre	5 vite
• Kompjuterat dhe pajisje elektronike	4 vite

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

(l) Aktivitet të qëndrueshme të patrupëzuara

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara përfshijnë programet kompjuterike. Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet për zhvillimin e programeve kompjuterike njihen si aktive kur Banka është në gjendje të tregojë qëllimin dhe aftësinë për të plotësuar zhvillimin dhe përdorimin e programeve kompjuterike në një mënyrë që të gjenerojë përfitime ekonomike të ardhme, dhe mundet të mase me besueshmëri kostot e përfundimit të zhvillimit. Kapitalizimi i kostove të programeve të zhvilluara nga vetë Banka përfshin të gjithë kostot që i atribuohen direkt zhvillimit të programit kompjuterik dhe amortizohen me jetën e dobishme të tyre. Zhvillimi i programeve kompjuterike shprehet me koston e kapitalizuar duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe rënie në vlerë.

Shpenzime vijuese për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime ndikojnë në rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të aktivitetit të cilit i ngarkohen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të programit kompjuterik duke filluar nga data në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme e programeve kompjuterike është katër vjet.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(m) Aktive afatgjata që mbahen për t'u shitur

Aktivitet afatgjata që pritet të merren nëpërmjet shitjes dhe jo kundrejt përdorimit të vazhdueshëm klasifikohen si të mbajtura për t'u shitur. Menjëherë pas klasifikimit si të mbajtura për t'u shitur, aktivitet rimaten sipas politikave kontabël të Bankës. Që nga ai moment, aktivitet maten me më të voglën mes vlerës kontabël dhe vlerës së drejtë minus kosto. Humbjet nga zhvlerësimi në klasifikimin fillestar si të mbajtura për t'u shitur dhe humbjet apo fitimi nga rimatja në vijimësi, njihen në fitim/humbje. Fitimet njihen deri në masën që nuk tejkalojnë ndonjë humbje kumulative nga rënia në vlerë.

(n) Rënia e vlerës e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për rënie vlere. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitet.

Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të matura për njësi gjeneruese të mjeteve monetare, fillimisht zvogëlojnë vlerën kontabël të ndonjë aktivi jo-material që është pjesë e njësisë dhe pastaj redukton vlerën kontabël të aktiveve të tjera në njësi (apo grup njësisë) me një shpërndarje proporcionale mes tyre.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është me e madhja ndërmjet vlerës së tij të drejtë, minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuarara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave, që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitet. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për evidencë nëse humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më.

Një humbje për zhvlerësim anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësim anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitet nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(o) Depozitat

Depozitat janë pjesë e burimeve të financimit të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të riblerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) më një çmim fiks në të ardhmen ("repo"), marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivitet vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të transaksionit, dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç rastit kur Banka zgjedh të mbajë detyrimin me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim/humbjes.

(p) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe ka shumë të ngjarë që për të shlyer detyrimin, të kërkohej një dalje e burimeve që përbëjnë të mira ekonomike. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, sipas rastit, rreziqet specifike të detyrimit.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(p) Provizionet (vazhdim)

Një provizion për ristrukturimin njihet kur Banka ka aprovuar një plan të detajuar dhe formal dhe ristrukturimi ka filluar apo është publikuar. Kosto të ardhme operative nuk provizionohen.

Një provizion për "kontratat pa fitim" njihet kur përfitimi i pritshëm nga këto kontrata, janë më të vogla se kostot e pashmangshme për të plotësuar detyrimin sipas kontratës. Provizionin matet me më të voglën mes vlerës së drejtë dhe kostos së pritshme të mbarimit të kontratës dhe kostos së pritshme për të vazhduar kontratën. Para se një provizion të krijohet, Banka njeh çdo humbje zhvlerësimi të aktiveve që lidhen me atë kontratë.

(q) Përfitimet e punonjësve

(i) Plan pensioni me kontribute të përcaktuara

Detyrimet për kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet Shqiptare janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

(ii) Plani i përfitimit të pensionit

Banka ka krijuar një fond për planin e pensionit quajtur Programi i Mbështetjes së Stafit ('SSP'), sponsorizuar tërësisht nga punëdhënësi (shiko shënimin 22 "Fondi rezervë për punonjësit që do të dalin në pension") në vitin 2002. Shuma që regjistrohet tek ky fond vendoset në fillim të vitit në masën 5% të shpenzimeve vjetore të planifikuara për pagat e personelit. Gjatë vitit, shuma e përlogaritur regjistrohet në fitim/humbje dhe tek fondi në bazë mujore.

Shumës së përmendur me sipër, përlogaritur për punonjësit i shtohet interes, i cili llogaritet që nga data kur punonjësit do të largohen dhe deri në daljen e tyre në pension. Kjo shumë do t'i paguhet punonjësve, vetëm kur ata të mbërrijnë moshën e pensionit, përcaktuar sipas ligjit shqiptar, në këste mujore të barabarta me minimumin e 75% e pensionit mujor shtetëror derisa fondi i akumuluar për punonjësit të konsumohet.

Bazuar në rezolutën e Këshillit Drejtues, në fuqi që nga 30 Shtatori 2010, Banka ka ndaluar së investuari në këtë fond, duke e transformuar atë në Programin e Kredisë për Mbajtjen e Stafit ('SRCP').

Ndryshimet demografike në forcën punëtore gjatë dhjetë viteve të fundit dhe moshë mesatare e punonjësve është 31, ku 80% e punonjësve janë nën moshën 40 vjeç, ka rezultuar se SSP nuk është tërheqës për punonjësit e Bankës pasi ai mund të gëzohet vetëm me daljen në pension. Në dallim nga ky plan, SRCP do të jetë më i dobishëm për të gjithë punonjësit e Bankës, sepse do t'u japë mundësi për kredi për shtëpi apo kredi konsumatore me terma preferencialë. Shuma e llogaritur nga SSP është ngrirë në 30 Shtator 2010 dhe shuma e ngrirë në të njëjtën datë dhe pjesa korresponduese e interesit vjetor, që do fitohet në të ardhmen deri në moshën e pensionit, dhe matet në bazë të normës së obligacioneve qeveritare AAA, do të regjistrohet nga Banka.

(iii) Përfitimet afat-shkurtra

Detyrimet e përfitimet afat-shkurtër të punonjësve maten në baza të paskontuara dhe janë shpenzuar ashtu siç kryhet shërbimi lidhur me to.

Provizioni njihet për shumën që pritet të paguhet sipas përfitimit afat-shkurtër ose planeve të ndarjes së fitimeve, nëse Banka ka një detyrim aktual ose konstruktiv të paguajë këtë shumë si rezultat i shërbimeve të kaluara të kryera nga punonjësit dhe detyrimet mund të maten në mënyrë të besueshme.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(r) Raportimi i segmenteve

Një segment operues është një komponent i Bankës që është i përfshirë në aktivitete biznesi, nga të cilat mund të fitojë të ardhura dhe të kryejë shpenzime, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me transaksionet me komponentë të tjerë të Bankës, dhe rezultatet operative të të cilit, rishikohen në mënyrë të rregullt nga menaxhimi për të marrë vendime rreth ndarjes së burimeve të secilit segment dhe për të vlerësuar performancën e tyre, dhe për të cilin duhet informacion i veçantë i vlefshëm (shih notën 6). Forma e segmentimit të Bankës është bazuar në segmentimin gjeografik.

(s) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara

Disa standarde të reja, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime nuk janë ende në fuqi më 31 Dhjetor 2010, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara. Asnjë prej tyre nuk do të ketë efekt në pasqyrat financiare të Bankës, me përjashtim të:

• SNRF 9 *Instrumentat Financiarë* (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2013 ose më pas, ndërsa aplikimi i mëhershëm është i lejuar). Ky standart zëvendëson udhëzimet e SNK 39, *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja*, në lidhje me klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Standarti eliminon kategoritë ekzistuese të SNK 39 për aktivet financiare të mbajtura deri në maturim, të vlefshme për shitje dhe huatë dhe llogaritë e arkëtueshme.

Aktivitet financiar do të klasifikohen në njërin prej dy kategorive në njohjen fillestare:

- aktive financiare të matura me kosto të amortizuar; ose
- aktive financiare të matura më vlerë të drejtë.

Një aktiv financiar matet me kosto të amortizuar nëse plotësohen dy kushtet e mëposhtme: aktivi mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet për të mbledhur flukset monetare sipas termave kontraktuale dhe sipas termave kontraktuale do rrjedhin flukse monetare në data të përcaktuara, që janë pagesa të këstit dhe të interesit mbi principalin e mbetur.

Fitimet dhe humbjet nga rimatja e aktiveve financiare me vlerë të drejtë njihen në fitim ose humbje, përveç rastit të një instrumenti investimi në kapital që nuk mbahet për t'u tregtuar, për të cilin SNRF 9 parashikon që me njohjen fillestare të bëhet një zgjedhje e pandryshueshme, për të paraqitur të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të investimit, në të ardhura të tjera përmbledhëse. Zgjedhja është e vlefshme për çdo aksion individualisht. Asnjë shumë e njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse nuk mund të riklasifikohet në fitim ose humbje në një datë të mëvonshme.

Pritet që aplikimi për herë të parë i Standartit të ri, do të ketë një ndikim në pasqyrat financiare, meqenëse do të aplikohet në mënyrë retrospektive. Sidoqoftë, Banka nuk është në gjendje të përgatisë një analizë të ndikimit që kjo do të ketë në pasqyrat financiare, deri në datën e aplikimit fillestar. Banka nuk e ka vendosur ende se kur do të fillojë aplikimin e Standartit të ri.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Drejtimi diskuton me Komitetin e Auditimit mbi zhvillimin, zgjedhjen dhe shënimet shpjeguese të politikave dhe vlerësimeve kritike të Bankës, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shih shënimin 5).

Fonde për humbjet nga zhvlerësimi i kredive

Aktivët e regjistruara me kosto të amortizuar vlerësohen për zhvlerësim në bazë të politikave kontabël të përshkruara në 3(g)(vii).

Banka rishikon portofolin e kredive për të përcaktuar zhvlerësimin në baza mujore. Në përcaktimin nëse humbja nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim/humbje, Banka bën gjykime nëse ka të dhëna që tregojnë se ka një rënie të konsiderueshme në flukset monetare të ardhme nga portofoli i kredisë para se rënia të identifikohet me një kredi individuale në atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se kanë ndodhur ndryshime të padëshiruara në statusin e pagesave të kredive në një grup, ose kushte ekonomike kombëtare apo lokale që lidhen me mospagimin e aktiveve në grup. Drejtimi përdor gjykime bazuar në eksperiencën e humbjes historike për aktivët me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe evidenca të zhvlerësimeve të ngjashme me ato të portofolit kur skedulohen flukset e ardhme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve të ardhme të parasë janë rishikuar në mënyrë të rregullt për të reduktuar çdo diferencë ndërmjet humbjes së vlerësuar dhe humbjes aktuale.

Investimet e mbajtura deri në maturim

Banka ndjek udhëzimet e SNK 39 në klasifikimin e aktiveve financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të përcaktuar, si të mbajtura deri në maturitet. Klasifikimi kërkon gjykime të rëndësishme. Në bërjen e këtij gjykimi, Banka vlerëson qëllimin dhe aftësinë e saj për të mbajtur investime të tilla deri në maturitet. Nëse Banka dështon të mbajë këto investime deri në maturitet, përveç rasteve të veçanta, për shembull shitja e një shume jo të konsiderueshme afër maturitetit, do të kërkohej që të klasifikohet e tërë kategoria, si e vlefshme për tu shitur. Investimet do të duhet të maten me vlerën e drejtë dhe jo me koston e amortizuar.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivët dhe detyrimet financiare për të cilat nuk ka një çmim tregu të dukshëm kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhen në politikën kontabël 3(g)(vi). Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe që nuk kanë transparencë në çmim, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon shkallë të ndryshme gjykimi bazuar në likuiditetin, përqendrimin, pasigurinë e faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe rreziqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik. Referoju gjithashtu "Vlerësimit të instrumenteve financiarë" më poshtë.

Gjykimet kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël të Bankës

Gjykime kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël të Bankës përfshijnë:

Vlerësimi i instrumenteve financiarë

Politika kontabël e Bankës për matjen e vlerës së drejtë është trajtuar në shënimin 3(g)(vi).

Banka e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmime të kuotuar në një treg aktiv për një instrument identik.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Vlerësimi i instrumenteve (vazhdim)

• Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në inpute të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur çmime të kuotuar në tregje aktive për instrumente të ngjashëm, çmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak se aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë të vëzhgueshëm në mënyrë direkte ose jo-direkte nga të dhënat e tregut.

• Niveli 3: Teknika vlerësimi që përdorin inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë ato instrumente ku teknika e vlerësimit përfshin inpute që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe inputet e pavëzhgueshme kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar bazuar në çmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm ku kërkohen rregullime apo gjykime të rëndësishme e të pavëzhgueshme për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Vlera e drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare që tregtohen në tregje aktive bazohen në çmime tregu të kuotuar apo kuotime të agjentëve. Për të gjitha instrumentet e tjerë financiarë Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modele të skontimit të flukseve monetare, krahasime me instrumente të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime të dukshme tregu dhe modele të tjera vlerësimi. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijnë në përcaktimin e vlerës së drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, i cili do të ishte përcaktuar nga pjesëmarrës në treg që veprojnë me kushtet e tregut.

Banka përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiarë më të thjeshtë dhe më të zakonshëm, si norma interesi dhe kembime monedhash që përdorin vetëm të dhëna tregu të vëzhgueshme dhe kërkojnë pak gjykim apo vlerësim nga drejtuesit. Çmimet e tregut dhe inputet e vëzhgueshme janë të vlefshme për instrumente kapitale dhe huaje të listuara në bursa, derivativë të tregtueshëm, dhe derivativë të thjeshtë si këmbimet e normave të interesit. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe e inputeve në model redukton nevojën për gjykimin dhe vlerësimin e drejtuesve dhe redukton gjithashtu pasiguritë që shoqërojnë përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe inputeve varion në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur ndaj ndryshimeve bazuar në ngjarjet specifike dhe kushtet e përgjithshme në tregjet financiare.

Për instrumente financiare më komplekse, Banka përdor modele vlerësimi të veçanta, të cilat janë zakonisht të zhvilluara bazuar në modele të njohura vlerësimi. Disa ose të gjithë inputet e rëndësishme në këto modele mund të mos jenë të vëzhgueshme në treg dhe janë rrjedhojë e çmimeve të tregut ose kurseve ose janë vlerësuar e bazuar në gjykime. Modelet e vlerësimit që përmbajnë inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi dhe vlerësimi nga drejtuesit në përcaktimin e vlerës së drejtë. Gjykimi dhe vlerësimi i drejtuesve kërkohet zakonisht për zgjedhjen e modelit të vlerësimit për t'u përdorur, përcaktimin e flukseve monetare të pritshme për instrumentin financiar që vlerësohet, përcaktimin e probabilitetit për mospagesën apo parapagimet nga pala tjetër dhe përzgjedhjen e normave të përshtatshme për skontim.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Vlera e drejtë

Tabela më poshtë analizon instrumentet financiare, të matura me vlerën e drejtë, sipas nivelit hierarkik, ku është kategorizuar matja e vlerës së drejtë.

31 Dhjetor 2010	Shënime	Vlera kontabël			Vlera e drejtë		
		Niveli 1	Niveli 2	Totali	Niveli 1	Niveli 2	Totali
Depozita dhe llogari me bankat	8	-	113,703,073	113,703,073	-	113,703,073	113,703,073
Bono thesari	9	-	187,826,686	187,826,686	-	188,104,036	188,104,036
Investime të vlefshme për shitje	10	85,936,698	15,778,047	101,714,745	85,936,698	15,778,047	101,714,745
Investime të mbajtura deri në maturim	11	-	275,915,418	275,915,418	-	277,321,670	277,321,670
Hua dhe paradhënie për bankat	12	-	68,810,445	68,810,445	-	68,810,445	68,810,445
Hua dhe paradhënie për klientët	13	-	551,045,870	551,045,870	-	551,045,870	551,045,870
Totali i aktiveve financiare		85,936,698	1,213,079,539	1,299,016,237	85,936,698	1,214,763,141	1,300,699,839
Detyrime ndaj klientëve	18	-	1,309,651,520	1,309,651,520	-	1,309,651,520	1,309,651,520
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	19	-	62,398,988	62,398,988	-	62,398,988	62,398,988
Totali i detyrimeve financiare		-	1,372,050,508	1,372,050,508	-	1,372,050,508	1,372,050,508
31 Dhjetor 2009							
Depozita dhe llogari me bankat	8	-	132,642,747	132,642,747	-	132,642,747	132,642,747
Bono thesari	9	-	255,640,833	255,640,833	-	255,893,441	255,893,441
Investime të vlefshme për shitje	10	47,439,776	2,080,287	49,520,063	47,439,776	2,080,287	49,520,063
Investime të mbajtura deri në maturim	11	-	194,965,671	194,965,671	-	195,087,755	195,087,755
Hua dhe paradhënie për bankat	12	-	45,487,888	45,487,888	-	45,487,888	45,487,888
Hua dhe paradhënie për klientët	13	-	494,271,286	494,271,286	-	494,271,286	494,271,286
Totali i aktiveve financiare		47,439,776	1,125,088,712	1,172,528,488	47,439,776	1,125,463,404	1,172,903,180
Detyrime ndaj klientëve	18	-	1,167,146,858	1,167,146,858	-	1,167,146,858	1,167,146,858
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	19	-	69,175,055	69,175,055	-	69,175,055	69,175,055
Totali i detyrimeve financiare		-	1,236,321,913	1,236,321,913	-	1,236,321,913	1,236,321,913

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar

(a) Të përgjithshme

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku i kredisë
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut
- Rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset e Bankës për matjen dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit.

Një instrument financiar është çdo kontratë që jep mundësinë për të marrë mjete monetare ose aktive të tjera financiare nga një palë tjetër (aktiv financiar) ose detyrimin për të dhënë mjete monetare ose ndonjë aktiv tjetër financiar ndonjë palë tjetër (detyrim financiar).

Instrumentet financiare rezultojnë me rrezik për Bankën. Rreziqet kryesore me të cilët përballet Banka janë rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit dhe ai i tregut. Rreziku i tregut përfshin rrezikun në monedhë të huaj, rrezikun e normës së interesit dhe rreziq të tjera çmimi.

Struktura e administrimit të rrezikut

Këshilli Drejtues ka përgjegjësinë e përgjithshme për themelimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut në Bankë. Këshilli ka themeluar Komitetin e Administrimit të Aktiv-Pasiveve (ALCO) dhe Komitetet e Rrezikut të Kredisë, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut në pjesët e tyre përkatëse. Të gjithë këta, i raportojnë në mënyrë të rregullt Këshillit Drejtues për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të rrezikut janë vendosur me qëllimin për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përballet Banka, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Banka, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë së politikave dhe procedurave për menaxhimin e rrezikut të Bankës, dhe për rishikimin e përshtatshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rrezikun me të cilin përballet Banka. Komiteti i Auditimit të Bankës ndihmohet në këtë funksion edhe nga Auditimi i Brendshëm. Auditimi i Brendshëm bën rishikime të rregullta, kontrollon administrimin e rrezikut dhe procedurave, rezultate të cilat raportohen në Komitetin e Auditimit.

(b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës nëse një klient apo pala tjetër e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe rrjedh kryesisht nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe bankave të tjera dhe nga investimet. Për qëllime të raportimit të administrimit të rrezikut, Banka konsideron të gjithë elementët e ekspozimit të rrezikut të kredisë (si rreziku i mospagimit të kredisë, rreziku i sektorit dhe vendit). Banka ka krijuar një komitet kredie për të mbikqyrur aprovimin e kërkesave të kredive. Kërkesat e kredive me shuma më të mëdha se 1,000,000 Euro aprovohen vetëm me vendimin e Këshillit Drejtues. Ka një fokusim të vazhdueshëm për cilësinë e kredive në momentin e aprovimit dhe gjatë jetës së tyre.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Çdo njësi kërkohet të jetë në përputhje me politikat dhe procedurat e kredisë së Bankës. Auditime të rregullta të njësive të biznesit dhe Departamentit të Administrimit të Rrezikut të Kredisë ndërmerren nga Auditimi i brendshëm.

Ekspozimi maksimal i rrezikut të kredisë

Ekspozimi maksimal i Rrezikut të kredisë para kolateralit dhe ndonjë rritjeje tjetër të kredisë me 31 dhjetor 2010 dhe 2009 paraqitet më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Bono thesari dhe bono të tjera të vlefshme	187,826,686	255,640,833
Të arkëtueshme nga bankat e tjera	182,513,518	178,130,635
Hua dhe paradhënie neto për klientët	551,045,870	494,271,286
Investime të vlefshme për shitje	101,714,745	49,520,063
Investime të mbajtura deri në maturim	275,915,418	194,965,671
Garanci financiare	21,083,914	21,634,109
Letra krediti	6,992,020	4,323,930
Angazhime për të dhënë kredi	30,704,665	23,744,714
Ekspozimi maksimal i rrezikut të kredisë	1,357,796,836	1,222,231,241

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuar

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuar janë ato hua dhe letra me vlerë për të cilat Banka ka përcaktuar se është e mundur që ajo nuk do jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë shumën e interesit dhe të principalit në bazë të kushteve të kontratës. Këto kredi cilësohen si A deri në D, sipas sistemit të brendshëm të Bankës për cilësimin e rrezikut të kredisë. Komiteti i Rrezikut të BKT është i angazhuar me cilësimin e klientëve dhe me kategorinë e tyre përkatëse. Komiteti i Rrezikut cilëson çdo kredi sipas këtyre faktorëve:

- Aftësinë për të paguar
- Kushtet financiare
- Aftësia e drejtimit
- Kolaterali dhe Garantuesit
- Struktura e kredive
- Industria dhe ekonomia

Nga Maji 2010, Banka ka zhvilluar "Metodologjinë e Vlerësimit të Kredive Tregtare dhe të Korporatave" sipas kërkesave të BASEL II dhe ka vendosur 9 vlerësime (nga AAA në C), me analiza cilësore dhe sasiore, raporte financiare dhe analiza për dy vite për të ruajtur dhe përmirësuar analizën e riskut. Këto vlerësime do të aplikohen për të gjithë analizat e kredisë, vit pas viti dhe grupe të kredive të vlerësuar do krijohen. Sidoqoftë, vlerësimi, dhe analiza dhe tranzicioni i tij, që do të krijojë një gjykim dhe marrje më të mirë vendimesh, nuk është finalizuar ende.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Hua dhe investime të vonuara por të pa-zhvierësuar

Hua të dhe investimet e vonuara por të pa-zhvierësuar janë ato për të cilat pagesat e interesit ose të principalit sipas kontratës, janë me vonesë por që Banka beson se zhvierësimi nuk është i përshtatshëm për shkak të garancisë/kolateralit të vlefshëm dhe/ose shkallës së arkëtimit të shumës që i detyrohen Bankës.

Hua me kushte të ndryshuara

Hua me kushte të ndryshuara janë hua të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe kur Banka ka bërë lëshime të cilat nuk do t'i bënte në rast të kundërt.

Pasi huaja është ristrukturuar, ajo qëndron në të njëjtën kategori, edhe pse performanca pas ristrukturimit mund të përmirësohet.

Fondi për zhvierësim

Banka vendos një fond për humbjet nga rëniet në vlerë, i cili përfaqëson vlerësimin e humbjeve të ndodhura në portofolin e kredive. Kjo lidhet me komponentin e humbjes specifike për ekspozimet e rëndësishme individuale. Referojuni shënimit 4.

Politika e fshirjes nga librat

Banka fshin një hua ose investim, dhe ndonjë fond për humbjet nga zhvierësimi prej tyre, me vendimin e Komitetit të Kredisë së Bankës, në përputhje me rregulloren e bankës së Shqipërisë "Mbi administrimin e rrezikut të kredisë". Vendimi i fshirjes merret pasi është marrë në konsideratë ndodhja e ndryshimeve në pozicionin financiar të huamarrësit, e tillë që con në paaftësi të huamarrësit për të paguar detyrimin, ose hyrjet nga kolaterali nuk janë të mjaftueshme për të paguar ekspozimin e mbetur.

31 Dhjetor 2010	Hua dhe paradhënie për klientët			
	Individe	Korporata	Paradhënie	Totali
Pa ditë-vonesa dhe zhvierësim	136,272,166	292,172,343	3,403,722	431,848,231
Me ditë-vonesa por jo të zhvierësuar	3,316,947	15,830,599	17,347	19,164,893
Të zhvierësuar në mënyrë individuale	40,700,299	68,465,896	2,572,915	111,739,110
Totali i kredive, bruto (Shënim 13)	180,289,412	376,468,838	5,993,984	562,752,234
Fondi i zhvierësimit	(4,553,231)	(4,629,714)	(2,523,419)	(11,706,364)
Totali kredive, zbritur zhvierësimin	175,736,181	371,839,124	3,470,565	551,045,870

31 Dhjetor 2009	Hua dhe paradhënie për klientët			
	Individe	Korporata	Paradhënie	Total
Pa ditë-vonesa dhe zhvierësim	112,152,302	310,496,018	4,471,513	427,119,833
Me ditë-vonesa por jo të zhvierësuar	2,507,943	772,233	301,359	3,581,535
Të zhvierësuar në mënyrë individuale	31,194,924	41,401,658	1,897,077	74,493,659
Totali i kredive, bruto (Shënim 13)	145,855,169	352,669,909	6,669,949	505,195,027
Fondi i zhvierësimit	(6,166,720)	(2,859,944)	(1,897,077)	(10,923,741)
Totali kredive, zbritur zhvierësimin	139,688,449	349,809,965	4,772,872	494,271,286

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Shihni më poshtë një analizë sipas cilësisë së kredisë për kreditë e korporatave:

Vlerësimi	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
A – Mirë	3,849,357	23,489,059
B – Pranueshëm	293,494,511	280,148,911
C – Nën monitorim	52,492,209	29,288,840
D – E papranueshme	21,642,890	16,828,881
(Shënimi 13)	371,478,967	349,755,691
Interesi i përllogaritur	6,125,362	4,003,653
minus: të ardhurën e komisionit të shtyrë e të pa amortizuar	(1,135,491)	(1,089,435)
Totali	376,468,838	352,669,909

Me poshtë paraqitet lista e huave dhe paradhënieve për klientët, ku vlera e tyre kontabël është rinegociuar:

	Hua dhe paradhënie për klientët			Totali kredive
	Individë	Korporata	Paradhënie	
31 Dhjetor 2010	701,253	18,333,581	141,353	19,176,187
31 Dhjetor 2009	473,188	9,513,024	-	9,986,212

Më poshtë paraqitet analiza e ditë-vonesave si të zhvlerësuara ashtu edhe të pa-zhvlerësuara:

31 Dhjetor 2010	Hua dhe paradhënie për klientët			Totali kredive
	Individë	Korporata	Paradhënie	
Ditë-vonesa deri në 31 ditë	11,130,329	21,001,353	389,247	32,520,929
Ditë-vonesa 32-60 ditë	3,372,554	4,035,210	296,679	7,704,443
Ditë-vonesa 61-90 ditë	3,719,625	3,756,951	320,984	7,797,560
Ditë-vonesa 91-180 ditë	3,196,617	24,278,483	196,380	27,671,480
Ditë-vonesa 181 ditë - 365 ditë	3,742,507	2,299,316	74,930	6,116,753
Ditë-vonesa 1-2 vite	2,406,835	3,951,799	83,526	6,442,160
Ditë-vonesa mbi 2 vite	1,287,893	6,346,600	24,542	7,659,035
Totali	28,856,360	65,669,712	1,386,288	95,912,360

31 Dhjetor 2009	Hua dhe paradhënie për klientët			Totali kredive
	Individë	Korporata	Paradhënie	
Ditë-vonesa deri në 31 ditë	8,361,839	3,452,186	753,165	12,567,190
Ditë-vonesa 32-60 ditë	3,888,949	2,225,796	67,533	6,182,278
Ditë-vonesa 61-90 ditë	2,288,738	2,196,984	57,875	4,543,597
Ditë-vonesa 91-180 ditë	2,195,042	1,143,711	-	3,338,753
Ditë-vonesa 181 ditë - 365 ditë	2,964,663	7,379,090	243,264	10,587,017
Ditë-vonesa 1-2 vite	1,926,824	7,907,945	82,114	9,916,883
Ditë-vonesa mbi 2 vite	891,469	901,834	-	1,793,303
Totali	22,517,524	25,207,546	1,203,951	48,929,021

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Më poshtë paraqitet një analizë e kolateralit dhe e sigurimeve të kredive gjatë vitit:

31 Dhjetor 2010	Hua dhe paradhënie për klientët			Totali kredive
	Individë	Korporata	Paradhënie	
Ndertesa Rezidenciale, tregtare ose industriale	514,869,439	789,023,289	-	1,303,892,728
Aktive financiare	7,101,789	93,329,874	-	100,431,663
Të tjera	31,904,257	98,185,168	-	130,089,425
Totali	553,875,485	980,538,331	-	1,534,413,816

31 Dhjetor 2009	Hua dhe paradhënie për klientët			Totali kredive
	Individë	Korporata	Paradhënie	
Ndertesa Rezidenciale, tregtare ose industriale	373,660,522	665,055,918	-	1,038,716,440
Aktive financiare	4,206,043	121,505,830	-	125,711,873
Të tjera	26,275,644	28,042,086	-	54,317,730
Totali	404,142,209	814,603,834	-	1,218,746,043

Cilësia e aktiveve të tjera financiare, bazuar në sistemin e vlerësimit të brendshëm të Bankës paraqitet si më poshtë:

31 Dhjetor 2010	Bono thesari	Llogari të tjera me bankat	Portofoli i vlefshëm për tu shitur	Portofoli i mbajtur deri në maturim	Totali
Mirë	187,826,686	182,513,518	101,714,745	275,915,418	747,970,367
Pranueshëm	-	-	-	-	-
Nën monitorim	-	-	-	-	-
Totali	187,826,686	182,513,518	101,714,745	275,915,418	747,970,367

31 Dhjetor 2009	Bono thesari	Llogari të tjera me bankat	Portofoli i vlefshëm për tu shitur	Portofoli i mbajtur deri në maturim	Totali
Mirë	255,640,833	178,130,635	49,520,063	194,965,671	678,257,202
Pranueshëm	-	-	-	-	-
Nën monitorim	-	-	-	-	-
Totali	255,640,833	178,130,635	49,520,063	194,965,671	678,257,202

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Bonot e thesarit, investimet e vlefshme për tu shitur, dhe investimet e mbajtura deri në maturim ndahen si më poshtë:

<i>Vlerësimi i Moody's ose ekuivalente te tij</i>	Shënime	2010	2009
Obligacione të qeverisë dhe bonot e thesarit	9,10,11		
Vlerësuar A2 në Aa1		14,711,110	20,400,518
Vlerësuar Baa3 në Baa1		18,146,194	5,488,838
Vlerësuar Ba3 në Ba2		14,277,190	12,656,266
Vlerësuar B1		423,446,040	417,708,061
Obligacione të korporatave	10,11		
Vlerësuar Baa1		17,848,389	3,250,524
Vlerësuar Ba3		13,144,154	6,746,513
Vlerësuar B3 në B2		12,768,893	6,870,204
Obligacione të bankave	10,11		
Vlerësuar Ba2 në Ba1		10,779,511	6,173,300
Vlerësuar Ba3		37,303,501	7,436,049
Vlerësuar B2 në B1		3,031,867	13,396,294
Total		565,456,849	500,126,567

Vlerësimi për huatë dhe paradhëniet për klientët detajohet në shënimin 12.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Banka monitoron përqendrimin e rrezikut të kredisë sipas sektorit dhe pozicionit gjeografik. Një analizë e përqendrimit të rrezikut të kredisë nga huatë dhe paradhëniet dhe letrat me vlerë në datën e raportimi paraqitet më poshtë:

	Shenimi	Huatë dhe paradhëniet për klientët		Huatë dhe paradhëniet për bankat		Investimet në letra me vlerë të borxhit	
		2010	2009	2010	2009	2010	2009
Vlera kontabël	9-11,12,13	551,045,870	494,271,286	68,810,445	45,487,888	565,456,849	500,126,567
Përqendrimi sipas sektorit							
Korporata		371,022,237	333,970,700	-	-	43,761,436	16,867,240
Qeveri		816,887	15,839,265	-	-	470,580,534	456,253,683
Banka		-	-	68,810,445	45,487,888	51,114,879	27,005,644
Individe		179,206,746	144,461,321	-	-	-	-
Totali		551,045,870	494,271,286	68,810,445	45,487,888	565,456,849	500,126,567
Përqendrimi sipas vendndodhjes							
	Shenimi	Huatë dhe paradhëniet për klientët		Huatë dhe paradhëniet për bankat		Investimet në letra me vlerë të borxhit	
		2010	2009	2010	2009	2010	2009
Shqipëria		389,644,225	382,829,120	-	-	423,446,040	417,708,061
Kosova		90,873,488	55,350,287	-	-	-	-
Evropa		70,528,157	56,091,879	56,935,264	45,487,888	142,010,809	70,756,368
Azia		-	-	11,875,181	-	-	6,173,300
Lindja e Mesme dhe Afrika		-	-	-	-	-	5,488,838
Totali	9-11,12,13	551,045,870	494,271,286	68,810,445	45,487,888	565,456,849	500,126,567

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku aktual ose i ardhshëm ndaj të ardhurave dhe kapitalit që vjen nga pamundësia e Bankës për të shlyer detyrimet e saj në afatin e tyre. Qëllimi i Menaxhimit të rrezikut të likuiditetit (MRL) është që të sigurojë se Banka mund të shlyejë të gjitha detyrimet për pagesë në afatin e tyre, pa krijuar humbje të papranueshme. Politika MRL e Bankës përfshin mënyrën se si Banka e identifikon, mat, monitoron dhe e kontrollon këtë risk.

Organizimi i MRL: Organizimi i MRL në Bankë përfshin dy organizma të ndryshëm në monitorimin dhe menaxhimin e likuiditetit. Përfshirja e organizmave të ndryshëm ndihmon në një shpërndarje më të qartë të përgjegjësiave për monitorimin/raportimin dhe menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Menaxhimi ditor i likuiditetit i përket Thesarit, por monitorimi ditor i rrezikut të likuiditetit dhe përputhja me limitet i përket Grupit të Menaxhimit të Riskut. Qëllimi kryesor i Grupit të Menaxhimit të Riskut, i cili ushtron kontrollin ditor të raporteve MRL, është që ti japë sinjale të hershme menaxhimit të lartë të Bankës për paralajmërimin e rrezikut të likuiditetit.

Raportet MRL: Politika MRL e Bankës përfshin grupe raportesh ditore dhe mujore për t'u parë dhe kontrolluar nga Departamenti i Rrezikut të Tregut dhe Operacional. Raportet ditore përfshijnë tabelën e Daljeve Maksimale Kumulative dhe tabelën e Ndarjes Kumulative të Aktiveve dhe Pasiveve, të cilat kontrollojnë përkatësisht hyrjet/daljet ditore dhe mujore të likuiditetit deri në maturitetin 1 vit sipas skenarit "biznes normal". Raportet mujore përfshijnë tabelat e likuiditetit për testet e stresit, të cilat kontrollojnë hyrjet/daljet ditore dhe mujore të likuiditetit sipas skenarëve të veçantë për kriza të Bankës dhe kriza të tregut deri në maturitetin 3 muaj.

Perqasja MRL e Bankës më 31 Dhjetor 2010 rezultoi me hendek likuiditeti pozitiv për të gjithë grupet kohore deri në një vit. Kjo ka ndodhur kryesisht për këto tre supozime:

- Duke përdorur metodën statistikore dhe të dhënat historike (derivuar që nga viti 2001) raporti i MRL-së aktuale përfshin analiza bazuar në modelin e sjelljes së ri-investimit të depozitave.
- Investimet afat-shkurta të mbajtura për tregtim konsiderohen likuide prej financimit të siguruar nga Banka e Shqipërisë.
- Kërkesat e mbajtjes së rezervës me BSH konsiderohen si aktive jo-likuide.

Më poshtë paraqitet një analizë e pritshme e flukseve monetare sipas maturitetit të mbetur.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Me 31 Dhjetor 2010, aktivet, detyrimet dhe kapitali aksionar i Bankës kanë maturitet kontraktual të mbetur si më poshtë:

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Aktivët						
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	177,385,066	-	-	-	-	177,385,066
Depozita dhe llogaritë me bankat	81,946,194	3,029,595	28,727,284	-	-	113,703,073
Bono thesari	22,705,175	33,260,413	131,861,098	-	-	187,826,686
Investime të vlefshme për shitje	-	-	-	89,785,335	11,929,410	101,714,745
Investime të mbajtura deri në maturim	14,325,457	522,938	23,541,099	237,525,924	-	275,915,418
Hua dhe paradhënie për bankat	-	20,133,160	30,092,312	18,584,973	-	68,810,445
Hua dhe paradhënie për klientët	31,319,654	34,421,267	116,874,115	252,691,257	115,739,577	551,045,870
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	-	-	-	5,892,236	10,583,214	16,475,450
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	-	-	-	1,610,738	-	1,610,738
Aktive afatgjata që mbahen për t'u shitur	-	-	5,206,635	-	-	5,206,635
Aktive të tjera	3,207,420	-	-	-	-	3,207,420
Totali aktiveve	330,888,966	91,367,373	336,302,543	606,090,463	138,252,201	1,502,901,546
Detyrimet dhe kapitali aksionar						
Detyrime ndaj klientëve	426,645,696	236,590,906	589,579,731	55,655,773	1,179,414	1,309,651,520
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	38,637,903	5,003,878	76,630	11,208,346	7,472,231	62,398,988
Detyrime ndaj palëve të treta	2,151,892	-	-	-	-	2,151,892
Detyrime tatimore të shtyra	-	-	-	1,731,801	-	1,731,801
Detyrime të tjera	6,300,403	-	429,874	-	1,567,221	8,297,498
Kapitali aksionar	-	-	-	-	118,669,847	118,669,847
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar	473,735,894	241,594,784	590,086,235	68,595,920	128,888,713	1,502,901,546
Rreziku i likuiditetit	(142,846,928)	(150,227,411)	(253,783,692)	537,494,543	9,363,488	-
Kumulative	(142,846,928)	(293,074,339)	(546,858,031)	(9,363,488)	-	-

Raportet MRL prodhohen për secilën monedhë Lek, Euro dhe USD dhe për totalin e pozicionit financiar gjithashtu. Limitet kumulative maksimale të flukseve dalese, të cilat menaxhohen dhe monitorohen në baza ditore, janë caktuar për secilën nga monedha e mësipërme.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Më 31 Dhjetor 2009, aktivet, detyrimet dhe kapitali aksionar i Bankës kanë maturitet kontraktual të mbetur si më poshtë:

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Aktivët						
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	142,263,329	-	-	-	-	142,263,329
Depozita dhe llogaritë me bankat Bono thesari	115,637,114	1,617,809	15,387,824	-	-	132,642,747
Investime të vlefshme për shitje	-	-	-	31,074,694	18,445,369	49,520,063
Investime të mbajtura deri në maturim	11,934,852	6,991,633	20,469,927	155,569,259	-	194,965,671
Hua dhe paradhënie për bankat	-	-	45,487,888	-	-	45,487,888
Hua dhe paradhënie për klientët	15,323,789	35,286,943	224,963,456	119,866,687	98,830,411	494,271,286
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	-	-	-	7,424,050	11,947,434	19,371,484
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	-	-	-	1,518,375	-	1,518,375
Aktive afatgjata që mbahen për t'u shitur	-	-	1,297,477	-	-	1,297,477
Aktive të tjera	3,062,500	-	-	-	-	3,062,500
Totali aktiveve	302,857,518	96,358,291	496,149,565	315,453,065	129,223,214	1,340,041,653
Detyrimet dhe kapitali aksionar						
Detyrime ndaj klientëve	397,375,804	214,953,386	511,357,665	41,590,446	1,869,557	1,167,146,858
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	69,175,055	-	-	-	-	69,175,055
Detyrime ndaj palëve të treta	456,415	-	-	-	-	456,415
Detyrime tatimore të shtyra	-	-	-	736,954	-	736,954
Detyrime të tjera	6,102,019	-	-	-	1,753,698	7,855,717
Kapitali aksionar	-	-	-	-	94,670,654	94,670,654
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar	473,109,293	214,953,386	511,357,665	42,327,400	98,293,909	1,340,041,653
Rreziku i likuiditetit	(170,251,775)	(118,595,095)	(15,208,100)	273,125,665	30,929,305	-
Kumulative	(170,251,775)	(288,846,870)	(304,054,970)	(30,929,305)	-	-

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj Rrezikut të likuiditetit

Nje indikator kryesor që përdoret nga Banka për administrimin e rrezikut të likuiditetit, i cili kërkohet nga Banka e Shqipërisë në të njëjtën kohë, është raporti i aktiveve likuide në baza javore. Bazuar në rregulloren Nr.71 date 14.10.2009 "Politika e administrimit të rrezikut të likuiditetit" ky raport duhet të jetë më i vogël se 20%. Sipas kësaj rregulloreje, Neni 19, pika 4, aktivet likuide janë konsideruar: balancat e mjeteve monetare, llogaritë rrjedhëse me BSH, duke përfshirë rezervën e detyrueshme deri në gjysmën e përdorimit të saj, Bonot e thesarit dhe investimet sipas maturitetit të mbetur dhe aftësinë për tu bërë likuide. Detyrimet afat-shkurta konsiderohen të gjitha detyrimet me maturitet të mbetur deri në një vit.

Raportet në datën e raportimit janë si më poshtë:

	<i>31 Dhjetor 2010</i>	<i>31 Dhjetor 2009</i>
Aktivet likuide/Detyrimet afat-shkurta	23.74%	26.42%

(d) Rreziku i tregut

1) Rreziku i kursit të këmbimit

Rreziku i monedhës së huaj është rreziku sipas të cilit, vlera e instrumenteve financiare luhetat në sajë të ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor. Banka e menaxhon këtë rrezik duke vendosur dhe monitoruar limitet mbi pozicionet e hapura dhe gjithashtu duke u siguruar që këto pozicione të jenë në përputhje me udhëzimet e Bankës së Shqipërisë dhe kufijve të brendshëm operacionale të Bankës. Banka ka vendosur procedura për një kontroll të pavarur të pozicioneve të hapura në monedhë të huaj.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

1) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

Tabela më poshtë paraqet shumën ekuivalente të aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit aksionar sipas monedhave më 31 Dhjetor 2010 dhe 2009 sipas kërkesave të Bakës së Shqipërisë të paraqitjes në monedhë të huaj:

31 Dhjetor 2010	Lek	USD	Euro	Të tjera	Totali
Aktivët					
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	96,785,816	11,355,428	68,653,967	589,855	177,385,066
Depozita dhe llogaritë me bankat	11,064	35,475,966	74,604,862	3,611,181	113,703,073
Bono thesari	183,744,215	-	4,082,471	-	187,826,686
Investime të vlefshme për shitje	15,778,047	20,589,560	52,837,361	12,509,777	101,714,745
Investime të mbajtura deri në maturim	205,915,490	30,387,953	39,611,975	-	275,915,418
Hua dhe paradhënie për bankat	-	16,414,423	52,396,022	-	68,810,445
Hua dhe paradhënie për klientët	204,837,848	78,860,500	264,232,258	3,115,264	551,045,870
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	13,253,486	-	3,221,964	-	16,475,450
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	1,610,738	-	-	-	1,610,738
Aktive afatgjata që mbahen për t'u shitur	4,674,698	-	531,937	-	5,206,635
Aktive të tjera	1,651,043	407,759	1,148,202	416	3,207,420
Totali aktiveve	728,262,445	193,491,589	561,321,019	19,826,493	1,502,901,546
Kontratat spot të kursit këmbimit	1,688,341	6,590,103	533,731	2,616,642	11,428,817
Detyrimet dhe Kapitali aksionar					
Detyrime ndaj klientëve	702,867,224	83,203,298	507,176,143	16,404,855	1,309,651,520
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	21,292,078	4,499,760	36,607,150	-	62,398,988
Detyrime ndaj palëve të treta	2,151,892	-	-	-	2,151,892
Detyrime tatimore të shtyra	1,731,801	-	-	-	1,731,801
Detyrime të tjera	2,597,672	4,501,446	1,140,274	58,106	8,297,498
Kapitali aksionar	34,047,647	84,622,200	-	-	118,669,847
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksionar	764,688,314	176,826,704	544,923,567	16,462,961	1,502,901,546
Kontratat spot të kursit këmbimit	476,789	2,501,333	2,815,429	5,635,266	11,428,817
Pozicioni (GAP)	(35,214,317)	20,753,655	14,115,754	344,908	-
Kumulative	(35,214,317)	(14,460,662)	(344,908)	-	-
Aktivët totale / totali i detyrimeve dhe kapitali	95.40%	111.57%	102.58%	101.56%	100.00%
GAP / Aktivët në monedhë të huaj		0.10	0.025	0.0154	-
Analiza e sensitivitetit					
Lek zhvlerësuar me 10%		1,886,696	990,345	31,355	2,908,396
Lek zhvlerësuar me 5%		988,269	518,752	16,424	1,523,445
Lek vlerësuar me 5%		(1,092,298)	(573,357)	(18,153)	(1,683,808)
Lek vlerësuar me 10%		(2,305,962)	(1,210,421)	(38,323)	(3,554,706)

Aktivët e qëndrueshme, të trupëzuara në monedhë të huaj lidhen me degën e Kosovës.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

1) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

31 Dhjetor 2009	Lek	USD	Euro	Të tjera	Totali
Aktivet					
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	70,302,833	11,560,606	59,636,791	763,099	142,263,329
Depozita dhe llogaritë me bankat	-	43,320,764	76,104,931	13,217,052	132,642,747
Bono thesari	253,631,437	-	-	2,009,396	255,640,833
Investime të vlefshme për shitje	2,080,287	36,051,207	8,138,045	3,250,524	49,520,063
Investime të mbajtura deri në maturim	161,996,337	13,960,347	19,008,987	-	194,965,671
Hua dhe paradhënie për bankat	-	9,343,313	36,144,575	-	45,487,888
Hua dhe paradhënie për klientët	204,847,219	58,882,739	226,853,783	3,687,545	494,271,286
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	15,844,953	-	3,526,531	-	19,371,484
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	1,518,375	-	-	-	1,518,375
Aktive afatgjata që mbahen për t'u shitur	1,297,477	-	-	-	1,297,477
Aktive të tjera	1,898,099	310,713	853,314	374	3,062,500
Totali aktiveve	713,417,017	173,429,689	430,266,957	22,927,990	1,340,041,653
Kontratat spot të kursit këmbimit	722,263	8,170,777	791,963	2,460,544	12,145,547
Detyrimet dhe Kapitali aksionar					
Detyrime ndaj klientëve	658,300,519	81,413,243	410,282,480	17,150,616	1,167,146,858
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	63,207,050	263,157	5,704,848	-	69,175,055
Detyrime ndaj palëve të treta	456,415	-	-	-	456,415
Detyrime tatimore të shtyra	736,954	-	-	-	736,954
Detyrime të tjera	2,509,797	4,176,007	1,131,949	37,964	7,855,717
Kapitali aksionar	16,371,654	78,299,000	-	-	94,670,654
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksionar	741,582,389	164,151,407	417,119,277	17,188,580	1,340,041,653
Kontratat spot të kursit këmbimit	636,965	2,457,614	863,959	8,187,009	12,145,547
Pozicioni (GAP)	(28,080,074)	14,991,445	13,075,684	12,945	-
Kumulative	(28,080,074)	(13,088,629)	(12,945)	-	
Aktivet totale / totali i detyrimeve dhe kapitali	96.22%	109.00%	103.13%	100.05%	100.00%
GAP / Aktivet në monedhë të huaj		0.08	0.030	0.001	-
Analiza e sensitivitetit					
Lek zhvlerësuar me 10%		1,362,859	868,105	1,177	2,232,141
Lek zhvlerësuar me 5%		713,878	454,722	616	1,169,216
Lek vlerësuar me 5%		(789,023)	(502,587)	(681)	(1,292,291)
Lek vlerësuar me 10%		(1,665,716)	(1,061,017)	(1,438)	(2,728,171)

2) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të luhetet në varësi të ndryshimeve të normave të interesit të tregut. Departamenti i Thesarit i Bankës e menaxhon rrezikun e normës së interesit nëpërmjet monitorimit të kushteve të tregut dhe duke ndërmarrë vendime të nevojshme për ripërcaktimin e çmimit ose rialokimin e investimeve pas miratimit të Komitetit të Aktiveve dhe Pasiveve. Analiza sensitivitetit është bërë bazuar në ekspozimin e normës së interesit për aktivet dhe detyrimet financiare, duke supozuar që vlerat e mbetura në datën e raportimit ishin po aq gjatë të gjithë vitit.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

2) Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

Norma mesatare efektive e ponderuar e kategorive të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës në 31 Dhjetor 2010 paraqitet më poshtë:

	<i>Lek</i>	<i>USD</i>	<i>Euro</i>
Aktivet			
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	3.50%	0.10%	0.70%
Depozita dhe llogaritë me bankat	N/A	2.86%	1.06%
Bono thesari	8.03%	N/A	5.66%
Investime	9.47%	6.92%	7.23%
Hua dhe paradhënie për bankat	-	5.03%	2.83%
Hua dhe paradhënie për klientët	11.70%	8.95%	9.07%
Detyrimet			
Detyrime ndaj klientëve	5.06%	1.52%	2.62%
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	5.19%	0.55%	1.92%

Norma mesatare e ponderuar efektive e kategorive të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës në 31 Dhjetor 2009 paraqitet më poshtë:

	<i>Lek</i>	<i>USD</i>	<i>Euro</i>
Aktivet			
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	3.68%	0.10%	0.70%
Depozita dhe llogaritë me bankat	N/A	1.64%	0.40%
Bono thesari	9.23%	N/A	N/A
Investime	10.46%	6.54%	8.05%
Hua dhe paradhënie për bankat	-	2%	2.39%
Hua dhe paradhënie për klientët	13.34%	8.81%	9.17%
Detyrimet			
Detyrime ndaj klientëve	5.33%	1.52%	3.38%
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	5.32%	0.10%	0.10%

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

2) Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

Datat e ri-çmimit të interesit të kategorive të rëndësishme për aktivet dhe detyrimet financiare të Bankës në 31 Dhjetor 2010 paraqiten më poshtë:

	<i>Deri në 1 muaj</i>	<i>1-3 muaj</i>	<i>3-12 muaj</i>	<i>1-5 vite</i>	<i>Mbi 5 vite</i>	<i>Totali</i>
Aktivët						
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	177,385,066	-	-	-	-	177,385,066
Depozita dhe llogaritë me bankat	81,946,194	3,029,595	28,727,284	-	-	113,703,073
Bono thesari	22,705,175	33,260,413	131,861,098	-	-	187,826,686
Investime të vlefshme për shitje	-	-	15,778,047	74,007,288	11,929,410	101,714,745
Investime të mbajtura deri në maturim	14,325,457	37,059,931	115,421,520	109,108,510	-	275,915,418
Hua dhe paradhënie për bankat	-	20,133,160	30,092,312	18,584,973	-	68,810,445
Hua dhe paradhënie për klientët	435,246,461	8,495,854	55,779,144	39,013,643	12,510,768	551,045,870
Totali	731,608,353	101,978,953	377,659,405	240,714,414	24,440,178	1,476,401,303
Detyrimet						
Detyrime ndaj klientëve	426,645,696	236,590,906	589,579,731	55,655,773	1,179,414	1,309,651,520
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	38,637,904	5,003,878	18,757,206	-	-	62,398,988
Totali	465,283,600	241,594,784	608,336,937	55,655,773	1,179,414	1,372,050,508

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

2) Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

Datat e ri-çmimit të interesit të kategorive të rëndësishme për aktivet dhe detyrimet financiare të Bankës në 31 Dhjetor 2009 paraqiten më poshtë:

	<i>Deri në 1 muaj</i>	<i>1-3 muaj</i>	<i>3-12 muaj</i>	<i>1-5 vite</i>	<i>Mbi 5 vite</i>	<i>Totali</i>
Aktivët						
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	142,263,329	-	-	-	-	142,263,329
Depozita dhe llogaritë me bankat	115,637,114	1,617,808	15,387,825	-	-	132,642,747
Bono thesari	14,635,934	52,461,906	188,542,993	-	-	255,640,833
Investime të vlefshme për shitje	-	-	2,080,287	28,994,407	18,445,369	49,520,063
Investime të mbajtura deri në maturim	11,934,852	32,510,660	110,392,333	40,127,826	-	194,965,671
Hua dhe paradhënie për bankat	-	-	45,487,888	-	-	45,487,888
Hua dhe paradhënie për klientët	355,240,709	8,212,269	78,264,522	39,573,894	12,979,892	494,271,286
Totali	639,711,938	94,802,643	440,155,848	108,696,127	31,425,261	1,314,791,817
Detyrimët						
Detyrime ndaj klientëve	397,375,804	214,953,386	511,357,665	41,590,446	1,869,557	1,167,146,858
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	69,175,055	-	-	-	-	69,175,055
Totali	466,550,859	214,953,386	511,357,665	41,590,446	1,869,557	1,236,321,913

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

2) Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

Sensitiviteti i normës së interesit

Analiza e sensitivitetit paraqitur më poshtë është përgatitur bazuar në ekspozimin e normave të interesit në datën e raportimit dhe ndryshimit të supozuar në fillim të vitit financiar dhe konstant gjatë gjithë periudhës. Më poshtë paraqitet efekti i ndryshimit të normave të interesit, duke supozuar që të gjithë variablat e tjerë mbahen konstant:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Rritja e normës së interesit me 2%	1,454,580	983,793
Rritja e normës së interesit me 1.5%	1,090,935	737,845
Rritja e normës së interesit me 1%	727,290	491,896
Zvogëlimi i normës së interesit me 1%	(727,290)	(491,896)
Zvogëlimi i normës së interesit me 1.5%	(1,090,935)	(737,845)
Zvogëlimi i normës së interesit me 2%	(1,454,580)	(983,793)

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë që vjen si rezultat i një sërë shkaqesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Bankës, dhe nga faktorë të jashtëm përveç rreziqeve të kredisë, tregut dhe likuiditetit si p.sh ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregullatore si edhe nga standardet përgjithësisht të pranuar të sjelljes së korporatave. Rreziqet operacionale lindin si pasojë e të gjithë operacioneve të Bankës.

Objektivi i Bankës është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balançojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Bankës me efektivitetin e përgjithshëm të kostove, si edhe të shmangë procedurat e kontrollit të cilat kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin.

Implementimi i kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional mbështetet nga zhvillimi i standardeve të administrimit të rrezikut të operacioneve si më poshtë:

- kërkesa për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë dhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkesa për rakordimin dhe monitorimin e transaksioneve
- pajtim me kërkesat dhe rregullat ligjore
- dokumentim i kontrolleve dhe i procedurave
- kërkesa për vlerësimin periodik të rreziqeve operacionale të identifikuar dhe përshtatshmërinë e kontrolleve dhe procedurave për të adresuar rreziqet e identifikuara
- kërkesa për raportimin e humbjeve operative dhe veprimi rregullues i propozuar
- zhvillimi i planeve mbuluese
- zhvillimi trajnues dhe profesional
- standardet etike dhe të biznesit
- zvogëlim i riskut, duke përfshirë sigurim në rastet kur është efektiv.

Përputhshmëria me standardet e brendshme është mbështetur nga një program rishikimesh periodike të ndërmarra nga Auditimi i Brendshëm. Rezultat e Auditimit të Brendshëm janë diskutuar me administrimin e njësisë së biznesit me të cilën ato lidhen, me përmbledhje të dërguara Komitetit të Auditimit dhe Drejtimit të Bankës.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Administrimi i kapitalit

Politika e Bankës është të mbajë një bazë kapitali të fortë për të mbajtur besimin e investitorëve, kreditorëve dhe tregut dhe për të mbështetur zhvillimet e ardhme të biznesit. Njihet ndikimi i nivelit të kthimit prej kapitalit aksionar, dhe Banka njuh gjithashtu nevojën për të mbajtur ekuilibrat ndërmjet kthimeve të larta që mund të jenë të mundura me nivel më të lartë huaje dhe avantazheve dhe sigurisë që ofron një pozicion i fortë i kapitalit. Nuk ka pasur ndryshime materiale në administrimin e kapitalit të Bankës gjatë periudhës.

Kapitali rregullator

